



RAPORT

***MBI GJENDJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT
NË DREJTORITË DHE KOMISARIATET E POLICISË,
NË INSTITUCIONET E PARABURGIMIT
DHE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE***

GJATË PERIUDHËS MAJ – NËNTOR 2012



**ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT**



**CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS**

RAPORT

***MBI GJENDJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT
NË DREJTORITË DHE KOMISARIATET E
POLICISË, NË INSTITUCIONET E PARABURGIMIT
DHE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE***

GJATË PERIUDHËS MAJ – NËNTOR 2012

Tiranë, Dhjetor 2012

Ky publikim është realizuar në kuadër të projektit “Për më shumë fuqizim të mbrojtësve të të drejtave të njeriut në Shqipëri”, i cili zbatohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinki në partneritet me Civil Rights Defenders dhe mbështetet financiarisht nga Swedish International Development Cooperation Agency.



**KOMITETI SHQIPTAR I
HELSINKIT**



Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton qëndrimin e Civil Rights Defenders.

Përgatiti për botim: M.A. Klejda Ngjela
M.A. Cand. Mag. Edlira Papavangjeli

Përkthimi: Anri Pashaj

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni me Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. “Gjin Bue Shpata”,
Pall. 5/1, Ap. 4, Tiranë, Shqipëri
Tel: 04 233671
E-mail: office@ahc.org.al;
www.ahc.org.al

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen e botuesit.

Botues: © Komiteti Shqiptar i Helsinkit

TABELA E LËNDËS

HYRJE

PJESA E PARË	SITUATA NË INSTITUCIONET E PARABURGIMIT DHE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE.....	5
- Metodologjia e misioneve monitoruese.....		9
- Vështrim i përgjithshëm i situatës së respektimit të të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria në institucionet penitenciare.....		11
- Sugjerime për përmirësimin e respektimit të të drejtave dhe të trajtimit të të paraburgosurve/të dënuarve.....		35

PJESA E DYTË	SITUATA NË DREJTORITË DHE KOMISARIATET E POLICISË.....	39
- Metodologjia e misioneve monitoruese.....		41
- Vështrim i përgjithshëm i situatës së respektimit të të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria në institucionet policore....		42
- Sugjerime për përmirësimin e respektimit të të drejtave të njeriut në drejtoritë dhe komisariatet e policisë.....		52

SHTOJCAT

Shtojca Letra dërguar autoriteteve shtetërore dhe disa nga përgjigjet e marra prej tyre.....	57
---	----

Pjesa I

SITUATA NË INSTITUCIONET E PARABURGIMIT DHE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

HYRJE

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), organizata e parë e të drejtave të njeriut, e krijuar në vitin 1990, ka për mision mbrojtjen, edukimin dhe sensibilizimin e opinionit publik dhe të organeve shtetërore për një respektim më të mirë të të drejtave të shtetasve. Monitorimi i respektimit të të drejtave të personave të mbajtur në institucionet e privimit të lirisë ka vite që tërheq vëmendjen e veçantë të KShH-së.

Prej vitesh KShH vëzhgon situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në institucionet e privimit të lirisë, ndër to edhe në drejtoritë dhe komisaritet e policisë në vend. Siguria publike është thelbësore për funksionimin e mirë të shoqërisë, por nga ana tjetër strukturat e policisë, duhet të ushtrojnë funksionet e tyre në respektim të plotë të të drejtave të personave të privuar nga liria. Duke pasur parasysh këtë mision dyfish të Policisë së Shtetit, KShH evidenton në këtë raport nevojën e vazhdueshme të vigjilencës në respektim të të drejtave të personave që përballen me policinë e shtetit.

KShH dëshiron të theksojë se, në përvojën e tij, periudha menjëherë pas shoqërimit/ndalimit/arrestimit përbën rrezikun potencial për ushtrim presioni psikologjik dhe/ose për keqtrajtime fizike dhe verbale. Ndaj dhe respektimi i të drejtave dhe trajtimi i personave të privuar nga liria në përputhje me ligjin nga ana e policisë së shtetit, është garanci përkundrejt çdo lloj forme të mundshme të abuzimeve.

Nën fokusin e vëzhgimit të KShH janë edhe institucionet e mbyllura penale, të cilët akomodojnë të paraburgosur dhe të dënuar. Cilësia e mirë e jetës në një institucion penitenciar varet kryesisht nga marrëdhëniet mira të krijuara mes personelit dhe personave të privuar nga liria nëpërmjet trajtimit njerëzor dhe me dinjitet që duhet t'i garantohet personave të privuar nga liria; varet nga zbatimi i një programi kuptimplotë dhe të larmishëm të veprimtarive, si dhe nga kushtet e përgjithshme fizike të jetës në institucion. Në këtë kuptim, klima e sigurt e krijuar nëpërmjet frymës së hapur të komunikimit mes personelit dhe personave të privuar nga liria

merr rëndësi të veçantë në garantimin e sigurisë fizike dhe dinamike të personave të privuar nga liria.

Publikimi i këtij raporti është paraprirë nga një proces dialogu zyrtar me institucionet e vëzhguara nëpërmjet letërkëmbimit, po ashtu edhe realizimit të një tryeze e të rrumbullakët diskutimi, mbi gjetjet paraprake të tij. Autoritete e larta prezente në këtë tryezë i vlerësuan objektivisht gjetjet e raportit dhe u angazhuan për të marrë masat e duhura për të përmirësuar situatën, si dhe dhanë objeksionet e tyre në lidhje me aspekte të veçanta të raportit. KShH ka marrë në konsideratë sugjerimet e autoriteteve përkatëse të strukturave të policisë së shtetit dhe të paraburgim/burgjeve, dhënë në këtë tryezë.

METODOLOGJIA

Ky raport përmbledh gjetjet dhe rekomandimet e misioneve të monitorimit të rreth 50% të numrit të përgjithshëm të institucione penale dhe më konkretisht të I.P 'Jordan Misja', I.P 'Mine Peza', IEVP "Ali Demi" në Tiranë, I.E.V.P. Korçë, I.E.V.P Lezhë, I.E.V.P Vaqarr, I.E.V.P. Fushë-Krujë, I.E.V.P. Krujë, I.E.V.P. Peqin, I.E.V.P. Tepelenë, në I.P. Durrës, I.P. Vlorë dhe Qendra Spitalore e Burgjeve (QSB) në Tiranë. Vëzhgimet janë realizuar përgjatë muajve maj - nëntor 2012. Vëzhgimet në institucionet e I.P 'Jordan Misja', I.P 'Mine Peza', QSB dhe I.P. Durrës janë realizuar në bashkëpunimin me Njësinë e Parandalimit të Torturës, pranë Avokatit të Popullit.

Monitorimet kanë pasur për qëllim të vëzhgojnë kushtet e jetesës dhe trajtimin e përgjithshëm të personave të privuar nga liria në institucionet lartpërmendur, duke u përqendruar më së shumti tek trajtimi i grupeve në pozita të dobëta.

Gjatë vëzhgimeve u mbajtën parasysh standardet, të drejtat dhe rregullimet e përcaktuara në legjislacionin shqiptar, më konkretisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; Kodin e Procedurës Penale; ligjin nr. 9331, datë 21.04.1998, ndryshuar me ligjin nr. 10024, datë 27.11.2009, 'Për ekzekutimin e vendimeve penale'; ligjin nr. 9888, datë 10.03.2008, 'Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998, 'Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim', i ndryshuar dhe Rregulloren e përgjithshme e burgjeve. U mbajtën parasysh, gjithashtu, rekomandimet e KPT-së, të KE-së për Shqipërinë, rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe të KShH-së.

KShH, i vetëdijshëm për shkallën e lartë të vështirësisë dhe të specifikës së veçantë të monitorimeve në institucionet penitenciare, paraprakisht ka trajnuar vëzhguesit që morën pjesë në misionet monitoruese. Këta vëzhgues përbejnë një grup specialistësh me përvojë, të fushave të mjekësisë, jurisprudencës dhe shkencave sociale. Grupe me minimalisht dy vëzhgues kanë marrë pjesë në realizimin e vëzhgimeve.

Gjatë monitorimeve janë zhvilluar intervista me të paraburgosurit/ të dënuarit. Në secilin prej institucioneve të lartpërmendura, u zhvilluan intervista me një numër personash të privuar nga liria të mjaftueshme për të gjeneruar gjetjet relevante për situatën e të drejtave në sistemin e burgjeve.¹ Krahas këtyre intervistave, vëzhguesit kanë realizuar për secilin institucion intervista me rreth pesë punonjës, duke përfshirë drejtorët, përgjegjësit e sektorëve dhe punonjës të rolit bazë. Intervistat janë kryer duke përdorur pyetësorët e përgatitur paraprakisht për këto misione vëzhgimi.

Në përgjithësi, gjatë vëzhgimeve hasen vështirësi lidhur me besueshmërinë e informacioneve të marra gjatë kryerjes së vëzhgimeve. Shpesh, burime të ndryshme informacioni prezantojnë qasje të ndryshme të situatës së të drejtave të njeriut dhe respektimit të tyre. Për të kapërcyer këtë pengesë, është punuar duke kryqëzuar informacionet e marra, si dhe duke parë dokumentacionin e mbajtur nga institucionet përkatëse, gjithashtu, duke e ballafaquar atë me vëzhgimin konkretisht në terren. Qasja objektive në realizimin e vëzhgimeve ka qenë koncepti udhëheqës i çdo vëzhguesi të përfshirë në realizimin e tyre, duke prezantuar një situatë të balancuar dhe duke verifikuar në vend informacionet e marra. Në pamundësi të verifikimeve, KShH ka paraqitur pretendime të cilat mund të shqyrtohen më tej rast pas rasti nga autoritetet përkatëse të burgjeve.

Megjithëse KShH-në e njihnin mirë pothuajse të gjithë të intervistuarit mes personave të privuar nga liria dhe personelit të institucioneve penale, vëzhguesit në të gjitha rastet kanë bërë prezent qëllimin e kryerjes së këtyre monitorimeve dhe kanë garantuar ruajtjen e të dhënave personale të personave të intervistuar ashtu siç parashikohet në ligjin për të dhënat personale.

KShH-ja falënderon autoritetet e institucioneve të vëzhguara për krijimin e lehtësirave në mbarëvajtjen e vëzhgimeve të kryera në institucionet

¹ Në institucionet ku mbahen të mitur dhe gra janë zhvilluar intervista me të gjithë të miturit, si dhe me më shumë se gjysmën e numrit të grave të privuara nga liria.

penale. Bashkëpunimi me administratën e institucioneve të vëzhguara ka qenë i mirë, i udhëhequr nga mirëkuptimi reciprok për të kryer vëzhgimet, në një atmosferë të sigurt dhe me privatësinë e duhur.

- **Vështrim i përgjithshëm i situatës së respektimit të të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria në institucionet penitenciare**

Cilësia e mirë e jetës në një institucion penitenciar varet kryesisht nga marrëdhëniet mira të krijuara mes personelit dhe personave të privuar nga liria nëpërmjet trajtimit njerëzor dhe me dinjitet që duhet t'i garantohet atyre, varet nga zbatimi i një programi kuptimplotë dhe të larmishëm të veprimtarive, si dhe nga kushtet e përgjithshme fizike të jetës në institucion. Në këtë kuptim, klima e sigurt e krijuar nëpërmjet frymës së hapur të komunikimit mes personelit dhe personave të privuar nga liria merr rëndësi të veçantë në garantimin e sigurisë fizike dhe dinamike në institucionet penitenciare.

Nga vëzhgimi në terren rezulton se përgjithësisht, në institucionet e vëzhguara ofrohet siguri, e cila fokusohet më shumë drejt asaj fizike, sesa sigurisë dinamike. Megjithatë, ka edhe praktika të mira në këtë drejtim. Vlen të përmendim atmosferën e mirë që ekziston mes personelit dhe personave të privuar nga liria në sektorin e grave dhe të burrave të dënuar në institucionin “Ali Demi” në Tiranë, megjithëse kushtet fizike të institucionit lënë për të dëshiruar. Gjithashtu, gjatë vëzhgimeve nuk u vërejtën incidente apo ngjarje të rënda të cilat mund të cenonin sigurinë e përgjithshme të institucioneve, apo tentativa për vetëvrasje ose vet-dëmtime të personave të privuar nga liria.

Nga vëzhgimet u vu re se, në përgjithësi, drejtuesit e institucioneve i kushtonin rëndësi bashkëpunimit midis sektorëve, gjë që krijon premisa të mira të punës së personelit në institucionet penale. Duke pasur të njëjtin qëllim pune, por të zbatuar nga këndvështrime të ndryshme sipas detyrave dhe funksioneve të përcaktuara, punonjësit civilë dhe ata me uniformë e

kanë vlerësuar bashkëpunimin e mirë që ekziston mes tyre. Me gjithë përmirësimet në këtë aspekt, duke marrë në konsideratë rëndësisë e bashkëpunimit mes sektorëve të ndryshëm si çelësi i suksesit të punës në burgje, KSHH-ja inkurajon strukturat drejtuese të institucioneve penale dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB), të vazhdojnë t'i japin vëmendje të veçantë forcimit të bashkëpunimit mes personelit civil dhe atij me uniformë.

Duke krahasuar gjetjet me vëzhgimet e mëparshme të KSHH-së në institucionet penale, vlen të evidentohet si zhvillim pozitiv se ekziston një ndërgjegjësim dhe ndjeshmëri më e lartë e personelit sa i takon respektimit të të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria dhe për rrjedhojë edhe për garantimin e trajtimit të duhur të tyre në këto institucione. Kjo përbën bazën për krijimin e një klime të sigurt në këto institucione. Në vijimësi të këtij raporti do të ndalemi në aspekte pozitive dhe ato negative të vëzhguara në institucione me fokus grupet e veçanta si të miturit, gratë, personat me probleme mendore etj..

Përgjithësisht, vitet e fundit tendenca ka qenë ulja e mbipopullimit në sistemin e burgjeve në vend, e cila ka ardhur si rrjedhojë e disa faktorëve dhe politikave të ndjekura të tilla si zbatimi i vendimeve alternative të dënimeve me burgim, hapja e institucioneve penale të reja, aplikimi i amnistisë etj.. Sipas të dhënave zyrtare të ofruara nga Ministri i Drejtësisë më 10 dhjetor 2012, mbipopullimi aktual në institucionet penale është gjithsej 40 persona mbi kapacitetin e lejuar². Megjithatë, mbipopullimi në sektorët e paraburgimit në disa prej institucioneve të vëzhguara³ paraqitej problematik duke u kthyer në një problem serioz⁴. Në të gjitha institucionet e vëzhguara ku u konstatua ky problem të paraburgosurit e intervistuar e ngritën këtë shqetësim. Ky fakt problematik e ul

² Sipas fjalës së mbajtur nga Ministri i Drejtësisë në veprimtarinë e organizuar nga DPB-ja "Përtej pendimit", më 10 dhjetor 2012.

³ Në IEVP Lezhë, IEVP Tepelenë, IEVP Peqin, IEVP Fushë-Krujë.

⁴ IEVP Tepelenë prezantonte një situatë shumë problematike të mbipopullimit në sektorin e paraburgimit, ku thuajse të gjitha dhomat e këtij sektori kishte dy apo tre persona mbi numrin e shtretërve të vendosur. Në një rast u konstatua se në një dhomë prej 8 shtretërish, qëndronin deri 12 vetë.

konsiderueshëm cilësinë e përgjithshme të jetës në këto institucione dhe është shkëlqje e rëndë e të drejtave dhe trajtimit të personave të paraburgosurve.

Megjithëse gjatë vitit 2012 janë ndërtuar institucione të reja si IP Elbasan dhe është përmirësuar infrastruktura në disa burgje, vazhdon të ngelet problem çështja e infrastrukturës të vjetruar dhe jo të përshtatshme për trajtimin e të paraburgosurve/të dënuarve në disa prej institucioneve të vëzhguara si në IEVP “Ali Demi”, IP “Jordan Misja” IEVP Vaqarr, IP “Mine Peza”, IEVP Tepelenë, QSB. Probleme me infrastrukturën për fat të keq u konstatuan edhe në disa institucione të ndërtuar rishtazi, si IEVP Lezhë, IEVP Peqin, IEVP Fushë Krujë, IP Durrës. Lagështira nëpër mure, higjiena jo e mirë, mungesë të shtretërve, dyshekëve dhe e shtrojave personale, të cilat në shumicën e rasteve dukeshin shumë të konsumuara përbënin problem. Mungesa e energjisë elektrike për shumë orë gjatë ditës ishte një tjetër problem i konstatuar në disa prej institucioneve si IEVP Peqin, Vlorë, Durrës, Lezhë, Fushë-Krujë. Disa institucione si IEVP Fushë-Krujë, IP Vlorë, IP Durrës, kishin problem mos-furnizim me ujë të rrjedhshëm dhe mungesë të ujit të ngrohtë, ç’ka ndikon negativisht tek mbajtja e higjienës personale të të paraburgosurve / dënuarve.

Shërbimi i kujdesit shëndetësor për personat e privuar nga liria e tyre, është një aspekt me rëndësi të drejtpërdrejtë për vëzhgimet e KShH-së. Një nivel i pamjaftueshëm i kujdesit shëndetësor mund të çojë në situata që sjellin keqtrajtime apo trajtime çnjerëzore dhe degraduese. Për më tepër, shërbimi i kujdesit shëndetësor duhet të luajë një rol të rëndësishëm parandalues kundrejt keqtrajtimit të mundshme në institucionet e mbyllura. Disa nga shërbimet në fokus të vëzhgimit kanë qenë niveli i kujdesit shëndetësor, përfshirë rolin e tij parandalues, ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave shëndetësore të pacientëve, furnizimin me ilaçe, kujdesin dentar etj..

Së pari, dëshirojmë të evidentojmë faktin pozitiv të funksionimit të marrëveshjes tre paleshe midis Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit të Sigurimeve Shëndetësore, për të pajisur të

paraburgosurit dhe të dënuarit me libreza shëndetësore, ç’ka i përfshin ata automatikisht në skemën e sigurimeve shëndetësore të personave jo-aktivë. Gjatë vëzhgimeve u vu re që marrëveshja zbatohet në IP “Jordan Misja”, pritej të fillonte zbatimin në IP Durrës, IP “Mine Peza”e me rradhë në të gjitha institucionet penale.

Pothuajse në të gjitha institucionet e vëzhguara, përveç IP “Jordan Misja” Tiranë, kishin probleme me furnizimin me ilaçe. Mungesat vireshin re me së shumti për antibiotikë, por edhe grupime të tjera ilaçesh, kryesisht barna për qetësimin e dhimbjeve. Në të gjitha institucionet e vëzhguara u morën ankesa nga të burgosurit për plotësimin e nevojave të tyre për ilaçe nga institucioni dhe se shumicën e kohës ato siguroheshin nga familjarët e tyre⁵. Institucionet e vëzhguara përgjithësisht tentonin ta zgjidhnin këtë problem nëpërmjet shpenzimit të fondit për blerje të vogla, të cilat kryesisht mbulonin nevojat e të sëmurëve kronikë apo ilaçet e situatave emergjente.

Kujdesi dentar ishte një tjetër aspekt i kujdesit shëndetësor i vëzhguar nga KShH, niveli i të cilit linte për të dëshiruar. Shërbimi i ofruar kufizohej kryesisht në heqje dhëmbësh dhe shërbim terapeutik të limituar. Pajisjet e punës në shumicën e rasteve ishin të vjetruara apo jashtë funksionit. Mjekimet e nevojshme për kryerjen e terapive shpesh mungonin. Në tërësi ka një lloj neglizhence për të rritur cilësinë e këtij shërbimi, i cili ka nevojë imediate për t’u përmirësuar, në mënyrë që të plotësojë standardin e nevojshëm në këtë fushë.

Hartimi dhe zbatimi i një programi të larmishëm aktiviteteve (punë, arsimim, aktivitete sportive dhe rikrijuese, etj.) ka një rëndësi të veçantë për mirëqenien e të burgosurve. Kjo vlen për të gjitha institucionet, qoftë për të paraburgosurit, apo të dënuarit, si për ato me nivel të ulët, të

⁵ Jo të gjithë të burgosurit kanë kontakte të rregullta me familjarët e tyre, për shkak të ndryshme sociale. Ka shumë raste që ata vijnë nga një shtresë e varfër sociale, të cilët nuk kanë mundësi financiare të përballojnë shpenzimet e ilaçeve, veshmbathjeve apo të tjera nevoja të cilat këto institucione nuk i përmbushin.

mesëm apo të lartë sigurie⁶. KSHH-ja ka vërejtur se ka një qasje disi të diferencuar nga institucioni në institucion sa i takon këtij aspekti. Në disa institucione si IP Vlorë dhe IEVP “Ali Demi” ka larmishmëri aktivitete. Ka disa tendenca pozitive për të përmirësuar programet, kryesisht me kurse profesionale, megjithatë situata mbetet për t’u përmirësuar. Ndërkohë në disa institucionet tjera, pjesërisht për shkak të mungesës së ambienteve të paracaktuara për këtë qëllim dhe pjesërisht e justifikuar për arsye sigurie, të burgosurit kryejnë vetëm disa aktivitete sportive gjatë orarit të ajrimit si në IP “Jordan Misja”, IP “Mine Peza”, IP Tepelenë, etj.. Vlen të evidentojmë programet e mira që zbatohen në IEVP “Ali Demi” dhe pjesërisht në IEVP Tepelenë, institucione, që, megjithëse, kanë një infrastrukturë tejet të vjetëruar, kjo nuk i ka penguar personelin për të realizuar veprimtari të larmishme si edhe për të qenë krijues dhe përshtatur mjediset e kufizuara.

Tashmë qasja e zbatuar në institucionet penitenciare është që çdo i burgosur ka dosjen e vet psiko-sociale, në të cilën përshkruhet edhe plani individual i dënimit⁷. Në disa prej institucioneve të vëzhguara si IEVP “Ali Demi” apo IP “Jordan Misja” kishte trajtim të diferencuar për disa grupe në pozita të dobëta për të cilën do flasim më në detaje në vijim të raportit. Me keqardhje konstatojmë se kjo praktikë nuk ndiqej në të gjitha institucionet e vëzhguara, ku kishte të burgosur me të tilla nevoja.

KSHH i kushton vëmendje të veçantë zbatimit të praktikës disiplinore në institucionet penitenciare. Në thelb të saj, qëndron disiplinimi i personit të privuar nga liria në rastet e një shkeljeje të rregullores së institucionit. Zbatimi i masave disiplinore përveçse duhet të jetë bazuar në ligj, duhet të bëhet në proporcion me incidentin si dhe duhet kryer brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj. Moszbatimi i tyre në mënyrë të drejtë mund

⁶ Standardi i KPT-së kërkon që të burgosurit të kalojnë një kohë të arsyeshme jashtë dhomave të tyre, e cila duhet të jetë 8 orë ose më shumë, sidomos nëse kemi të bëjmë me persona të dënuar.

⁷ Sipas nenit 74 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, për çdo të burgosur duhet të *“hartohet programi individual i trajtimit, i cili realizohet nga një grup ekspertesh të fushave social-psikologjike e pedagogjike të drejtuar nga edukatori”*.

të çojë në keqtrajtim apo trajtim çnjerëzor dhe degradues të personave të privuar nga liria.

Në vijim paraqesim disa aspekte shqetësuese lidhur me këtë politikë: Nga vëzhgimi janë vërejtur që në ambientet e veçimit mbahen jo vetëm të burgosurit me masë disiplinore, por edhe të tjerë të burgosur për arsye si sjellja e tyre "shqetësuese" për të tjerët, për interes të një hetimi penal, me kërkesën e tyre, për shkaqe transferimi apo si rezultat i "rrezikshmërisë" së tyre. Disa nga arsyet e përmendura njihen dhe përdoren edhe në praktikën e sjellja nga vendet demokratike evropiane, megjithatë duhet të ketë protokolle/udhëzues administrativë të qartë për këto raste. Raste të tilla janë gjetur në IEVP Lezhë, IEVP Peqin, IEVP Durrës, IEVP Tepelenë, IP "Jordan Misja" Tiranë. Shqetësuese është fakti se këta të burgosur të mbajtur në të tilla kushte, nuk vizitoheshin çdo ditë nga një punonjës i sektorit të kujdesit social apo mjeku i institucionit, siç e kërkon procedura në të tilla raste.

Vendosja e personave të privuar nga liria sa më pranë familjes apo komunitetit ku kanë jetuar përpara se të burgoseshin duhet të jetë parimi udhëheqës në procesin e akomodimit të tyre. Gjatë vëzhgimeve, KShH-ja është njohur me ankesa të ngritura nga personat e privuar nga liria lidhur me transferimet e tyre nga një institucion në tjetrin. Disa të burgosur mund të jenë jashtëzakonisht e vështirë për t'u trajtuar dhe, transferimi i tyre nganjëherë mund të jetë i nevojshëm. KShH, pa dashur të paragjykojë vendimet e DPB-së për transferimet e personave të privuar nga liria, thekson se lëvizjet e vazhdueshme të një të burgosuri nga një institucion në tjetrin, mund të ketë efekte të dëmshme psikologjike dhe fizike të tij. Gjatë vëzhgimeve të KShH janë marrë disa ankesa për transferime të shpeshta⁸, pa i njoftuar dhe pa i lënë kohën e duhur të burgosurve për të marrë sendet e tyre personale.

⁸ Ndër të tilla ankesa veçojmë dy raste të dy të dënuarve nga IEVP Korçë, të cilët kishin hyrë në grevë urie prej rreth dy javës, të cilët u takuan nga KSHH gjatë qëndrimit të tyre në QSB. Ata nuk kishin asnjë ankesë sa i takon trajtimit në të dy këto institucione dhe thjesht kërkonin të transferoheshin në një institucion afër vendbanimit të familjes

Gjatë vëzhgimeve KShH ka vërejtur me kujdes situatën e të ashtuquajturve ‘persona tranzitë’, të cilët janë të dënuar, që kryejnë dënimin në institucione të ndryshme, që transferohen nëpër institucione të tjera penitenciare për disa ditë, të cilëve, u duhet të marrin pjesë në seanca gjyqësore, në çështje të natyrave të ndryshme. Të dënuar të tillë janë sistemuar nga institucionet përkatëse në dhomat e observimit, ku mund të qëndronin deri në pesë ose gjashtë ditë. Këto raste u vunë re në IP Durrës dhe IP “Jordan Misja”. Kushtet e dhomave ku mbaheshin këta të dënuar ishin jo të mira sa i takon higjienës, si dhe ata nuk ishin pajisur me shtroje apo veshmbathje të pastra personale⁹. Shumica prej tyre nuk e dinte sesa kohë do qëndronte në institucion. Të dënuarit nuk merrnin pjesë në asnjë aktivitet gjatë këtyre ditëve të qëndrimit aty.

KShH-ja sugjeron që praktika të tilla duhet të evitohen dhe analizohen shkaqet përse ndodhin. Rastet përjashtimore duhen rregulluar me udhëzime të veçanta administrative të Ministrisë së Drejtësisë/DPB-së për të parandaluar shkelje të të drejtave dhe trajtimit të personave në këto kushte.

E drejta e kërkesës dhe e ankesës që ka një person i privuar nga liria është një nga të drejtat themelore kushtetuese e rregulluar edhe nga ligji për të drejtat dhe trajtimin e personave të privuar nga liria¹⁰. KShH, duke pasur parasysh rëndësinë e garantimit në praktikë të kësaj të drejte dhe zbatimin e unifikuar të mekanizmit të kërkesës dhe ankesës, në bashkëpunim me grupin e punës së ngritur nga DPB me përfaqësues të institucioneve penale dhe ekspertë të burgjeve holandeze ka kontribuar në unifikimin e procedurave të këtij mekanizmi në të gjitha institucionet penitencare nëpërmjet një protokolli që u vjen në ndihmë personave të privuar nga liria

së tyre, siç parashikohet në nenin 72 të rregullores së Përgjithshme të Burgjeve “*Ne rastin e transferimeve të të dënuarve në institucione të tjera të vuajtjes së dënimit, duhet të merren parasysh kërkesat e të burgosurve dhe familjareve të tyre*”.

⁹ Të pyetur nga vëzhguesit e KSHH-së, ata pohuan se asnjëherë nuk ishin pajisur me veshmbathje apo shtroje personale; në krevatet e gjetura aty ishin të njëjtat shtroje të cilat nuk ndryshoheshin prej shumë kohësh.

¹⁰ Kjo e drejtë kushtetuese, garantohet edhe nëpërmjet nenit 58 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

dhe personelit të sistemit të burgjeve, si edhe nëpërmjet formateve që ndihmojnë për hartimin e kërkesave dhe ankesave të ndryshme. Kjo nismë ka filluar nga viti 2010 dhe përfundon në shkurt të vitit 2013, ndaj është herët të shihen frytet e unifikimit të këtij mekanizmi në praktikën e përditshme në burgje.

Në përgjithësi, nga vëzhgimet e kryera rezultoi se personat e privuar nga liria ishin të vetëdijshëm për mundësinë e bërjes së kërkesë-ankesave dhe e ushtronin këtë të drejtë. Nga vëzhgimet në dokumentacionin e mbajtur nga institucionet u vu re se kishte më shumë kërkesa sesa ankesa. KShH inkurajon drejtoritë e institucioneve penale dhe strukturat përkatëse në DPB të sigurojnë në vijimësi zbatimin e njëjtë të procedurës së kërkesës dhe ankesës në gjithë institucionet penale në mënyrë që të garantohet trajtimi efektiv, i drejtë dhe në kohë i kërkesave dhe ankesave duke respektuar konfidencialitetin e tyre në rastin e ankesave.

Së fundi, KShH dëshiron të theksojë rëndësinë e madhe që ka rritja e vazhdueshme profesionale e personelit në institucionet penale. Një personel profesional përbën garanci për respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria dhe mbarëvajtjen e mirë të punës në institucionet penale. Në këtë drejtim, vihet re praktika pozitive e vendosur tashmë nga sektori i trajnimeve pranë DPB-së për trajnimin me programe mësimore të veçanta për personelin me uniformë të punësuar rishtas në sistemin e burgjeve, të personeli të mesëm drejtues dhe trajnime vazhduese për nivelin e lartë drejtues në burgje dhe trajnime me tema të veçanta që realizohen herë pas here në bazë të nevojave. KShH-ja ka dhënë një kontribut të qenësishëm në hartimin e këtyre programeve të ndryshme mësimore dhe në realizimin e trajnimeve në bashkëpunim me sektorin e trajnimeve në DPB dhe ekspertë të praktikës së burgjeve holandeze. Megjithëse ka një praktikë të mirë, mbetet prioritet trajtimi vazhdues dhe i thelluar i personelit të burgjeve.

Lidhur me organikat në institucionet e vëzhguara vihet re një rritje e numrit të psikologëve të përfshirë në sektorin e kujdesit të veçantë ku trajtohen personat me probleme mendore, kjo më së shumti në

institucionet si në IP “Jordan Misja” Tiranë, IP Durrës, IEVP Fushë Krujë, IEVP Krujë, IEVP Tepelenë, IEVP Korçë dhe IP Vlorë. Por, me keqardhje konstatojmë se vihet re një mungesë e theksuar për mjekë psikiatër, shërbim ky shumë i domosdoshëm në burgjet që kanë një numër të konsiderueshëm të personave me probleme mendore¹¹.

Qëndrueshmëria e personelit të trajnuar merr rëndësi të veçantë për garantimin e shërbimeve cilësore në institucionet penale. Gjatë vëzhgimeve u vunë re shkurtime të personelit të sektorëve ndryshëm si në IEVP Korçë, IP Vlorë etj. Inkurajojmë DPB-në të zhvillojë politika përzgjedhje të personelit në sistemin e burgjeve bazuar mbi meritokracinë si dhe politika që garantojnë qëndrueshmërinë e personelit profesional duke shtrirë statusin e nëpunësit civil në gjithë institucionet penale. Garantimi i kushteve të pranueshme të punës për personelin është detyrim i autoriteteve drejtuese të Ministrisë dhe DPB-së. Gjatë vëzhgimeve u vunë re mungesa e mjediseve, pajisjeve si edhe e mjeteve të ndryshme ndihmëse të përshtatshme për zhvillimin e punës të punonjësve në institucione.

Trajtimi i grupeve në pozita të dobëta në institucionet penitenciare

Siç është përshkruar edhe në hyrje të këtij raporti, fokus i veçantë i këtij raundi vëzhgimesh të ndërmarra nga KShH ka qenë vëzhgimi i kushteve dhe trajtimit të grupeve në pozita të dobëta në burgje. Me grupe në pozita të dobëta kuptojnë ato kategori personash të privuar nga liria të cilët kanë ose duhet t’u garantohet një mbrojtje e veçantë ligjore dhe t’u garantohet një kujdes i veçantë nga institucionet penale. Të tilla grupe janë: të miturit, gratë, personat me probleme të shëndetit mendor, të varurit nga substancat narkotike, të dënuarit e përjetshëm apo ata me dënime afatgjata, personat LGBT¹², të moshuarit etj.. Për shkak të nevojave të

¹¹ Më shumë detaje për këtë shërbim do të lexoni në vijim të këtij raporti.

¹² Grupet e personave lesbike, gei, biseksual dhe transeksual.

veçanta që kanë të tillë grupe personash, por edhe për shkak të stigmatizimit të tyre nga shoqëria, gjë që mbartet edhe në institucionet penale, atyre u duhet ofruar një trajtim i veçantë në burgje.

Përgjithësisht, KShH ka vërejtur një ndërgjegjësim më të lartë sa i takon një trajtimi të diferencuar që duhet ofruar për të tillë grupe, falë edhe kontributit intensiv të organizatave të shoqërisë civile.

Më poshtë shtjellohet situata e vëzhguar në institucionet penitenciare të cilat trajtojnë të tilla grupe. Vëmendje të veçantë në këtë pjesë të raportit i është kushtuar tre grupeve më të 'ndjeshme' sa i takon nevojave specifike për trajtim siç janë personat me probleme të shëndetit mendor, të miturit dhe gratë e privuara nga liria.

Trajtimi i personave me probleme të shëndetit mendor në paraburgime/burgje

Një nga detyrat më të rëndësishme të sistemit të burgjeve dhe për rrjedhojë e të gjithë personelit që punon në institucionet vendore penale, është ofrimi i një kujdesi të veçantë që përfshin një trajtim të diferencuar bazuar në nevojat specifike të personave të privuar nga liria që kanë probleme të shëndetit mendor. Puna me të burgosurit me probleme të shëndetit mendor është gjithnjë një detyrë e vështirë për të gjithë punonjësit e burgjeve.

Thujse në të gjitha institucionet e vëzhguara janë gjendur të burgosur me probleme të shëndetit mendor (këtej e tutje pacientë), por ata më së shumti ishin të vendosur në IEVP Krujë, IP Durrës, QSB, IEVP Peqin, IEVP Korçë, IEVP Fushë-Krujë, etj..

Duke marrë parasysh rëndësinë e trajtimit të veçantë që duhet t'i bëhet këtyre pacientëve, KShH gjatë viteve 2009-2011 ndërmori një nismë në bashkëpunim me DPB dhe institucionet vendore penale për prezantimin për herë të parë në sistemin e burgjeve shqiptare të ngritjes së sektorëve të kujdesit të veçantë në burgje. Ky koncept ka në bazë të tij trajtimin e

diferencuar të këtyre personave, në kuptimin fizik në një sektor të veçantë, po ashtu edhe sa i takon trajtimin e tyre të diferencuar, me një program ditor që i përshtatet nevojave dhe mundësive të tyre. Fillimisht, kjo nismë u pilotua në disa burgje pasi ishte trajnuar personeli civil dhe ai me uniformë, që do të punonte me këta pacientë me një qasje të trajtimit multi-disiplinor. Vlen të evidentohet se institucioni “Ali Demi” Tiranë ende vazhdon të jetë një praktikë e mirë e kësaj nisme.

KShH-ja është e vetëdijshme që nisma të tilla kërkojnë kohë të konsolidohen, ndaj inkurajon DPB-në dhe institucionet vendore penale të mësojnë nga praktika e mirë e vendosur tashmë në një nga institucionet shqiptare.

Gjatë këtij raundi vëzhgimesh, KShH ka shqyrtuar nga afër kushtet e jetesës të pacientëve dhe trajtimin e tyre. Përveç institucionit “Ali Demi” ku sektori i kujdesit të veçantë funksionon sipas qasjes së trajtimit të individualizuar dhe multi-disiplinor, në institucionet e tjera ku ka pacientë të tillë kemi konstatuar se nuk reflektohet kjo qasje. Janë vënë re mangësi sa i takon kushteve materiale dhe trajtimit të këtyre pacientëve. Më konkretisht, në IEVP Krujë, ka një infrastrukturë të vjetër dhe të amortizuar që nuk i përshtatet nevojave të veçanta të personave me probleme mendore. Problem imediat mbeten tualetet kolektive në këtë institucion. Shoqërimi nga personeli për në tualet i këtyre personave, sidomos orët e natës, ua bën jetesën e vështirë pacientëve në këtë institucion. Ndërsa në IEVP Peqin, Fushë-Krujë, QSB etj. përgjithësisht, të tilla probleme ishin zgjidhur. Në shumicën e institucioneve të vëzhguara u vërejtën që dhomat e pacientëve ishin jo të mbajtura në rregull dhe me një higjienë pjesërisht të mirë.

Përgjithësisht, në institucionet e vëzhguara, është vërejtur që dokumentacioni mjekësor (kartelat apo regjistrat mjekësorë) janë mbajtur në rregull. Trajtim mjekësor psikiatrik, i cili merr rëndësi të veçantë për këta pacientë, duhet të bazohet në një qasje të individualizuar, që konkretizohet në hartimin e një plani trajtimi për çdo pacient. KShH ka vërejtur se ka mungesa të theksuara sa i takon shërbimi psikiatrik të ofruar

në këto institucione, i cili nuk mbulon si dhe sa duhet nevojat, ndonjëherë edhe imediate për një trajtim mjekësor të specializuar psikiatrik. Në institucionin e Krujës në organikë janë planifikuar 2 mjekë psikiatër, ndërsa faktikisht ky shërbim mbulohet nga një mjek me kohë të pjesshme i cili vinte një herë në tre ditë në institucion; në IP Durrës mjekja psikiatre sapo kishte lënë detyrën dhe pritej të zëvendësohej nga mjekja psikiatre e QSB për disa ditë në javë; nga ana tjetër, QSB kishte vetëm një mjeke psikiatre, e cila për shkak të nevojave që kishin institucionet e tjera penitenciare i duhej të punonte disa ditë jashtë QSB-së¹³.

Njëra nga arsyet e mosplotësimit të personelit me mjek psikiatër është edhe fakti se mjekët ndihet të demotivuar për arsye se marrin pagesë së barabartë me shërbimin e kryer në institucionet spitalore të specializuara jashtë sistemit të burgjeve. Duke marrë parasysh edhe përvojat e sjella nga praktikat e mira evropiane për këtë çështje, inkurajohet DPB, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë të gjejnë modalitete lehtësuese dhe motivuese për të rritur interesin e këtij shërbimi të specializuar në sistemin e burgjeve nëpërmjet uljes së ngarkesës dhe planëzimit më të mirë të mjekëve në qendrat civile shëndetësore si edhe nëpërmjet politikave të tjera favorizuese për mjekët psikiatër që punojnë në sistemin e burgjeve.

Në disa institucione të vëzhguara si në IP Durrës, IEVP Peqin, ishte edhe mungesa e ilaçeve për këtë grup pacientësh, nisur nga ilaçet e emergjencës, po ashtu edhe ato të terapisë së rregullt. Disa prej ilaçeve i përkisnin kategorive të vjetruar dhe të dala nga përdorimi i zakonshëm. Të vetëdijshëm për këtë problem, mjekët mendonin se të tilla probleme do të zgjidheshim me futjen në skemën e sigurimeve shëndetësore.

Trajtimi i përshtatshëm i këtij grupi, duhet të përfshijë një gamë të gjerë aktiviteteve rehabilituese dhe terapeutike të përcaktuara në planin individual të trajtimit për secilin person me probleme mendore. Këto

¹³ Mjekes psikiatre te QSB-së i duhej të punonte në ditë të ndryshme të javës në IP “Jordan Misja” dhe IEVP Ali Demi” Tiranë, IEVP Fushë – Krujë, IP Durrës.

veprimtari mund të jenë si terapi profesionale, terapi grupi, psikoterapi individuale, art, muzikë dhe sport të përshtatshëm për nevojat e tyre specifike. Trajtimi i diferencuar bazuar tek nevojat specifike për personat me probleme mendore merr po kaq rëndësi sa edhe trajtimi mjekësor i specializuar.

Ky trajtim rehabilitues dhe terapeutik psiko-social mungonte në IP Durrës dhe QSB ku u vu re një mungesë e theksuar e aktiviteteve të qenësishme jashtë dhomës. I vetmi moment kur pacientët qëndronin jashtë dhomave të tyre ishte kur dilnin në ajrim, apo nëse i thërriste psikologu apo mjeku. Pra, praktikisht këta persona qëndronin mesatarisht 20 orë të mbyllur brenda në dhomë. Për shkak të sëmundjes, shumë prej tyre nuk preferonin as të dilnin në ajrim për disa ditë më radhë. Ata që kishin TV në dhomë një shumicë të kohës e kalonin duke parë programe të ndryshme, të tjerët qëndronin shumicën e kohës të shtrirë në krevat. Shumë pak prej tyre merreshin me punë artistike ose krijuese në këtë IP Durrës.¹⁴ Kjo situatë bie ndesh me standardet që i garantohet këtyre personave në instrumentet ndërkombëtarë dhe në legjislacionin shqiptar. KShH sugjeron që të merren masa që në këtë institucion të përmirësohet programi ditor për këta pacientë me qasjen e trajtimit të diferencuar dhe të individualizuar.

Në institucionin e Krujës ishin reflektuar disa nga sugjerimet e KShH-së për përmirësimin e programit ditor për personat me probleme mendore, megjithatë mbetet punë për të konsoliduar një program ditor të larmishëm edhe në këtë institucion në të ardhmen. Nëpër institucionet e vëzhguara zhvillohen veprimtari sportive dhe argëtuese¹⁵, megjithatë ato mbeten të fragmentarizuara dhe jo pjesë e integruar e planit individual të pacientit.

Pjesë e vëzhgimeve të KShH-së sa i takon trajtimit të këtij grupi ka qenë edhe përdorimi i përshtatshëm i mjeteve të kufizimit apo të shtrëngimit fizik, pasi një keq-përdorim i tyre përbën mundësi për keqtrajtim të pacientëve. Kufizimi fizik i pacientëve të dhunshëm, që mund të dëmtojnë

¹⁴ Vetëm pak pacientë nga 45 të tillë.

¹⁵ Zakonisht veprimtaritë argëtuese realizoheshin me raste festash.

të tjerët apo e vet-dëmtohen mund të jenë të nevojshme të përdoren në raste krizash.

Kështu, vëzhgimet evidentojnë si pozitiv mospërdorimin e prangave si mjet të kufizimit të pacientëve të irrituar, krahasuar kjo me disa vite më parë, kur prangat përdoreshin rëndom për të kufizuar fizikisht këta të sëmurë. Në pamundësi të pasjes së mjeteve profesionale të kufizimit fizik, si këmisha force, apo krevate të posaçme, mjekët e QSB-së kishin ideuar përdorimin e disa rripave të lëkurës, me të cilat lidhnin pacientët në rast nevojë. Ndërsa mjekët e IP Durrësit përdornin fashat për këtë qëllim. Vetëm mjekët kishin tagrin të urdhërorin të tillë masë të kufizimit të këtyre pacientëve, por nuk kishte protokoll të qartë se për sa kohë duhet të qëndronte ky person i lidhur pas krevatit. Ky fakt lë vend për hamendësime për abuzime të mundshme me kohën e qëndrimit të një pacienti të lidhur në atë gjendje. Kufizimi i pacientëve duhet të jetë subjekt i një politike të përcaktuar qartë në udhëzues/protokolle administrativë.

Duke pasur parasysh natyrën sfiduese të punës së personelit që punon me këtë grup personash, KShH sugjeron DPB-në të kushtojë vëmendje të veçantë përzgjedhjes dhe trajnimit të duhur lidhur me trajtimin e diferencuar që duhet të realizojë personeli civil dhe ai me uniformë me pacientë me probleme mendore. Për më tepër, personeli që punon në këtë grup personash duhet të marrë trajnim e duhur për zgjidhjen e situatave problematike, për teknikat e mbrojtjes fizike nga pacientët të dhunshëm etj.. KShH me ekspertët shqiptarë dhe ata të praktikës holandeze të burgjeve kanë hartuar një modul trajnimi për personelin civil dhe ata me uniformë për të garantuar një qasje profesionale dhe të diferencuar për personat e dënuar me probleme mendore. Ky modul përfshin jo vetëm konceptin e punës me këta pacientë, por edhe instrumente konkrete të vlerësimit të gjendjes individuale të pacientëve, hartimin e një plani individual multi-disiplinor si edhe instrumente matës të progresit nga punonjësit sociale, psikologët dhe psikiatrit.

KShH-ja sugjeron që ky modul trajnimi të përdoret në mënyrë të vazhdueshme nga sektori i trajnimeve të burgjeve për të trajnuar gjithë personelin që punon me personat e dënuar me problemet mendore.

E fundit, por jo nga rëndësia, për trajtimin e personave të dënuar me probleme mendore, mbetet e nevojshme një mbikëqyrje nga afër e autoriteteve drejtuese të institucioneve vendore penale dhe DPB-së, për të shmangur çdo lloj abuzimi me këtë grup në pozita të dobëta. Marrim shkas nga një pretendimin për keqtrajtim të ngritur nga një e paraburgosur me inicialet M.K. gjatë vëzhgimit në QSB, e cila fajësonte një nga infermierët e QSB-së se gjatë mjekimit të plagës së saj i kishte shkaktuar qëllimisht dhimbje. Ajo pretendonte gjithashtu, se infermieri nuk e kishte mjekuar siç duhet. Pavarësisht se ky pretendim nuk u verifikua nga vëzhguesit e KShH-së dhe Njësisë për parandalimin e torturës nëse përbënte ose jo keqtrajtim, tërheqim vëmendjen e autoriteteve të burgjeve për t'i marrë seriozisht në shqyrtim kur pretendime të tilla ngrihen nga personat e dënuar me probleme mendore.

Në përfundim, KShH dëshiron të ndalet tek një problem shqetësues, tashmë i evidentuar prej shumë vitesh, lidhur me mbajtjen e personave me vendim gjyqësor me masën mjekësore “Mjekim i detyruar” në institucionet penale në kundërshtim flagrant të legjislacionit shqiptar dhe standardeve ndërkombëtare. KShH e ri-ngre me forcë çështjen shumë shqetësuese të mbajtjes në mënyrë të paligjshme të këtyre personave në Qendrën Spitalore të Burgjeve, në Institucionin e Veçantë në Krujë apo disa prej tyre edhe në institucione të tjera¹⁶. Sugjerojmë, që në mënyrë urgjente të përshpejtohen procedurat e ngritjes së një institucioni të specializuar në varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë që të garantojë trajtimin e specializuar për këta persona ashtu siç parashikohet në ligj.

¹⁶ Nga vëzhgimet janë konstatuar 4 raste të personave me masë “Mjekim i detyruar” në Peqin.

Situata e të miturve të paraburgosur

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 54 të saj, shprehet qartë se të miturit gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga shteti. Ata janë në thelb më të cenueshëm se sa të rriturit. Si pasojë, duhet kushtuar vëmendje e veçantë për t'u siguruar atyre mbrojtje fizike dhe mendore dhe trajtim të veçantë, duke pasur për qëllim minimizimin e pasojave që sjell mbyllja në institucion penal. Me këtë filozofi trajtimi një institucion apo sektor të veçantë për të mitur duhet të ofrojë klimë të sigurt për ta. Ambientet duhet të jenë me hapësirat e përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, por edhe të mbajtura rregullt dhe pastër dhe të mirë-dekoruara, për të dhënë modele të mira jetese. Për çdo të burgosur mungesa e aktiviteteve kuptimplote është e dëmshme, por për të miturit ajo është veçanërisht e dëmshme, për shkak të moshës së brishtë dhe nevojave të veçanta për aktivitet fizik, stimulim intelektual dhe modelim të sjelljeve pozitive dhe për rrjedhojë edhe e aftësive sociale. Pjesë thelbësore e programit të tyre ditor duhet të jetë arsimi i detyrueshëm 9 vjeçar (për ata që nuk e kanë përfunduar), aktivitetet sportive, kurset profesionale, krijimtari e ndryshme artistike dhe aktivitete të tjera të qëllimshme, punë në grup dhe ajo e individualizuar për rritjen e aftësive sociale dhe sjelljeve pozitive tek të miturit.

Puna me të miturit e privuar nga liria është një detyrë veçanërisht sfiduese. Personeli që punon me ta duhet të jetë i përzgjedhur me kujdes, me pjekuri personale dhe profesionale, si dhe me aftësi për të përballuar sfidat e përditshme të punës me ta, duke pasur parasysh gjithmonë ruajtjen e mirëqenies së kësaj grup-moshe.

Në raport me vëzhgimet e mëparshme, vihet re një ndërgjegjësim më i lartë i personelit që punon me të miturit. Ky është një fakt pozitiv i cili duhet të nxitet edhe më tej, për të pasur qëndrueshmëri në trajtimin e tyre të diferencuar.

Institucionet penitenciare të vëzhguara nga KShH gjatë këtij raundi vëzhgimesh, të cilat kanë nën kujdesin e tyre të mitur të paraburgosur kanë qenë IP Vlorë, IP "Jordan Misja" Tiranë, IEVP Lezhë dhe IEVP Korçë.

Nga vëzhgimet ka rezultuar se IP “Jordan Misja” dhe IP Vlorë në sektorët ku mbahen të miturit kishte mbipopullim¹⁷. Në IP “Jordan Misja” janë vendosur sektorë të të rriturve, grave dhe të të miturve të paraburgosur në një situata infrastrukturore tejte e rënduar për gjithë institucionin. KShH-ja tërheq vëmendjen e autoriteteve shtetërore t’i japin përparësi akomodimit të të miturve në institucione me kushte jetese të përshtatshme dhe mundësisht në institucione veçmas personave të rritur.

Në përgjithësi u vu re një situatë e mirë sa i takon rëndësisë që i jepte personeli kontakteve kryesisht me familjen dhe me botën jashtë. Si rezultat, të miturit kishin të drejtë të bënin dyfishin e telefonatave apo takimeve në muaj, në raport më të rriturit, por gjithashtu, asnjëherë nuk pengoheshin të bënin telefonata apo takime shtesë sa herë dëshironin apo kishin mundësi.

Sa i takon trajtimit të të miturve të paraburgosur u hasën disa probleme lidhur me zbatimin e strukturimit të rutinës ditore nga të miturit, një element tejte i domosdoshëm gjatë qëndrimit në institucion. Përgjithësisht në gjithë institucionet e vëzhguara, të miturit e bënin zgjimin e mëngjesit rreth orës 10.00 apo 11.00 të drekës, sepse flinin vonë në darkë. Në IP Vlorë, punonjësit e grupit të gatshëm ndërhyjnë çdo mëngjes për të bërë zgjimin e të miturve, të cilët pretendonin se këtë gjë e bënin duke ushtruar dhunë psikologjike edhe fizike. Megjithatë pretendimet nuk u verifikuan në vend, KShH sugjeron se metodat e përdorimit të dhunës fizike apo psikologjike duhet të shmangen në të gjitha rastet, por pa hequr dorë nga strukturimi dhe disiplinimi i të miturve. Sugjerojmë, që zgjimin e të miturve ta bëjë mundësisht personeli me uniformë i regjimit të brendshëm. Në rastet kur nuk ka bindje dhe bashkëpunim nga ana e të miturve, ndaj këtyre të fundit sugjerohet të merren masa të tilla si përjashtimi nga ndonjë aktivitet i përbashkët ose lënia e të miturit në dhomë për gjithë ditën.

Sigurisht, orientimi, edukimi dhe disiplinimi i të miturve bëhet në bashkëpunim me personelin e edukimit i cili në këto raste duhet të

¹⁷ Në IEVP “Jordan Misja” kishte 32 të mitur, po ashtu në IP Vlorë kishte 32 të mitur.

përdorë metoda bashkëkohore të “TIME OUT”, si edhe formate të vëzhgimit të sjelljes dhe shprehive tek të miturit që duhet të jenë pjesë e planit individual të zhvillimit të personalitetit të të miturit.

KShH-ja ka sjellë praktika të mira pune të cilat janë bërë bazë e trajnimeve kryesisht të personelit të Institucionit të të miturve Kavajë, të cilat nevojiten të përdoren në të gjitha institucionet ku mbahen të miturit. KShH sugjeron intensifikimin e punës për t’u garantuar një klimë të sigurt për gjithë të miturit në kujdesin e sistemit të burgjeve shqiptare.

Garantimi i të drejtës për arsim të detyrueshëm të të miturve është një detyrim ligjor i cili po gjen zbatim për të miturit e paraburgosur. Gjatë realizimit të vëzhgimeve IEVP Korçë, IEVP Lezhë, IP “Jordan Misja” Tiranë ofrohej arsimim i detyrueshëm 9 vjeçar, ndërsa në IP Vlorë nuk ofrohej kjo mundësi. Pas konstatimit të KShH-së dhe sugjerimit për marrjen e masave për garantimin e kësaj të drejte, na vjen mirë të mësojmë se edhe në këtë institucion u hap shkolla për realizimin e arsimit të detyrueshëm për të miturit.

Sa i takon zhvillimit të aktiviteteve situata ndryshonte nga institucioni në institucion. Në IP Vlorë realizoheshin një sërë kursesh edukative që i ofroheshin të miturve si kurse informatike, anglishteje dhe italishteje. Frekuentimi i bibliotekës, orët e diskutimeve në grup për tema të caktuara, këshillime individuale nga punonjësja sociale, aktivitete të ndryshme sportive, palestër dhe organizimi i orëve të kinemasë ishin pjesë e programit javor, të cilin të gjithë të miturit e konfirmuan se e njihnin dhe merrnin pjesë. Ndërsa nga vëzhgimi në sektorin e të miturve në IEVP Korçë, u konstatua nivel jo i mjaftueshëm i aktiviteteve të nevojshme, si dhe mungesa e ambienteve të përshtatshme si palestra, apo edhe të sallave për zhvillimin e aktiviteteve rikrijuese. Në IEVP Lezhë nuk zhvilloheshin mjaftueshëm aktivitete sportive dhe rikrijuese po ashtu edhe në IP “Jordan Misja”, për shkak se të miturit në këtë institucion kishin probleme/konflikte me njeri-tjetrin, të cilat i pengonin ata të zhvillonin në baza ditore aktivitete sportive të përbashkëta. Kjo situatë i pengonte ata të

zhvillonin edhe oraret e plota të ajrimit, për mungesa ambientesh për të gjithë¹⁸.

Në gjithë institucionet e vëzhguara, me përjashtim të IP Vlorë, shumica e aktiviteteve sportive zhvilloheshin gjatë orarit të ajrosjes. Problem për gjithë institucionet mbetej mangësia e aktiviteteve gjatë ditëve të fundjavës. Edhe mungesa e burimeve financiare për blerjen e pajisjeve të nevojshme për zhvillimin e këtyre veprimtarive ishte një pengesë më vete, siç ishte dhe konsumimi i shpejtë i pajisjeve/mjeteve sportive për shkak të ambienteve jo të përshtatshme për zhvillimin e tyre (p.sh. fushat sportive të betonizuara, apo dëmtimi i topave tek telat rrethuese).

Nga vëzhgimi i kryer në IP Vlorë, konstatoi se pak ditë para se të kryhej vëzhgimi, një i mitur kishte pësuar dhunë (*djegje të shumta me cigare në trup*) nga disa të mitur të tjerë të së njëjtës dhomë. Institucioni kishte marrë masat e duhura, pas konstatimit, duke e denoncuar rastin në Prokurori, duke mundësuar kështu procedimin penal. Duke qenë të cënueshëm për shkak të cilësive të moshës së adoleshencës, me këtë grup duhet pasur dyfish kujdes për t'i ruajtur nga të tilla dëmtime. KShH vlerëson denoncimin e rastit në organet përkatëse ligjore, por tërheq vëmendjen për më shumë kujdes parandalues i të tilla ngjarjeve, të cilat kanë një impakt negativ, jo vetëm tek i mituri në fjalë, por cenojnë sigurinë tek të gjithë të miturit.

Për më tepër, KShH sugjeron që me gjithë të miturit duhet të punohet në mënyrë të veçantë nga gjithë personeli i burgjeve dhe sidomos ai i kujdesit social për modelimin e sjelljeve pozitive, aftësimin social tek të miturit dhe disiplinimin e sjelljeve negative duke përdorur metoda bashkëkohore dhe pedagogjike. Këto metoda pune¹⁹ KShH përmes përvojës së burgjeve holandeze i ka prezantuar dhe ato kanë gjetur zbatim në institucionin e të miturve Kavajë. KShH ka hartuar module trajnimi enkas për trajtimin me metoda pedagogjike me të miturit dhe inkurajon sektorin e trajnimeve të

¹⁸ Mbipopullimit në sektorin e të miturve ishte një tjetër problem, i cili frenonte rritjen e efektivitetit të punës në këtë sektor.

¹⁹ Metoda U-Turn dhe Equip.

sigurojë trajnime vazhduese me gjithë personelin e institucioneve që kanë në kujdes të miturit. Gjatë vëzhgimit u vu re fakti pozitiv se në IP “Jordan Misja” Tiranë ishin marrë masa për ndryshimin e personelit që punon në këtë sektor, si dhe intensifikimin e punës për përmirësimin e situatës konfliktuale që ekzistonte mes të miturve.

Një tjetër problem i hasur gjatë vëzhgimit ishin disa pretendime të të miturve të IP Vlorë, me masë disiplinore të cilëve u ishin ndaluar takimet me familjarët dhe në ndonjë rast edhe kryerja e ajrimit. Megjithëse këto pretendime mbeten të paverifikuara, KShH sugjeron në parim evitimin e të gjitha rasteve kur të miturve u pengohet ajrimi ose takimet me familjarët gjatë kryerjes së masës disiplinore.

KShH ka vënë re gjatë vëzhgimit në IP “Jordan Misja” Tiranë, që për shkak të mbipopullimit tek sektori i të miturve dhe për rrjedhojë shfrytëzimi i gjithë mjediseve në këtë sektor për të miturit kishte çuar në mungesën e një mjedisi të veçimit në sektorin e të miturve. Për pasojë, të miturit me masë disiplinore vendoseshin në dhomat e veçimit tek të rriturit. KShH, e vetëdijshme për vështirësitë që sjell mbipopullimi në këtë sektor, tërheq vëmendjen se të gjitha procedurat disiplinore që zbatohen për të miturit duhet të shoqërohen me masa mbrojtëse formale dhe të trajtohen me rëndësinë e duhur, duke evituar maksimalisht kontaktet e mundshme të të miturve me të rriturit.

Së fundmi, problem i bërë prezent nga personeli i kujdesit social dhe i evidentuar nga vëzhgimet ishte puna e pakët, që kryesisht bëhet nga punonjësit e burgjeve për përgatitjen për lirim të të miturve. Ka pasur shumë raste të të miturve të cilët nuk kishin mbështetje nga familjarët apo të afërmit e tyre, dhe mungonin struktura alternative pritëse dhe për rrjedhojë lindte problemi i gjetjes së një vendi ku i mituri të mund të strehohej. Përgatitja për lirim nuk është vetëm përgjegjësi e personelit të burgjeve. Struktura të tjera shtetërore si shërbimi i provës, përfaqësuesit e zyrtarëve vendore të arsimit, punësimit, komunave dhe bashkive si edhe shërbimet e dhëna nga OJF-të e ndryshme duhet të bëhen pjesë e programit të marrjes së masave për të mundësuar një kthim të

suksesshëm të të miturve në shoqëri. KShH sugjeron që gjithë këto organe të përfshihen në bashkëpunim konstruktiv për të realizuar programe të mira të përgatitjes për lirim që kur të miturit janë në institucionet penale.

Situata e vëzhguar sa i takon trajtimit të grave të paraburgosura/dënuara

Gratë dhe vajzat e privuara nga liria janë një tjetër grup në pozita të dobëta në institucionet penale dhe si të tilla, KShH i kushtoi vëmendje të veçantë në këtë raund vëzhgimesh. Në përgjithësi, ato përfaqësojnë një pakicë relativisht të vogël të të gjithë popullatës në sistemin e burgjeve. Në pamje të parë ky është një fakt pozitiv, por nga ana tjetër kjo bën që përgjithësisht të ketë një vëmendje të pamjaftueshme për trajtimin përshtatshëm me nevojat e grave në institucionet penale. Pavarësisht këtij argumenti që do t'i kthehemi shpejt në këtë pjesë të raportit, ndërgjegjësimi që ka personeli i institucioneve penale për trajtim specifik për gratë në burgje ka ardhur në rritje.

Gratë e privuara nga liria kanë nevojë për shërbime specifike të cilat përshtaten me nevojat e tyre fizike dhe psiko-sociale. Ndër të tilla nevoja rendisim nevojën për kushte dhe pajisje higjienike të vazhdueshme, kujdes të shtuar shëndetësor gjinekologjik, masa parandaluese të kujdesit shëndetësor me rëndësi të veçantë për gratë, si analizat për të kancerin e gjirit dhe qafës së mitrës, kujdes psikiatrik etj.. Shpesh këto gra që gjenden në këto institucione janë edhe nëna me fëmijë, ndarja prej të cilëve sjell pasoja të rënda psikologjike për to.

Në vendin tonë janë dy institucione që trajtojnë gratë dhe vajzat në konflikt me ligjin, IP 'Jordan Misja' Tiranë, që trajton gratë dhe vajzat e paraburgosura, dhe IEVP 'Ali Demi' që trajton gratë dhe vajzat e dënuara. Në vijim paraqiten gjetjet konkrete nga vëzhgimet e zhvilluara në këto institucione.

Dy aspekte të ndryshme që tregojnë për mungesën e një vëmendje të duhur për gratë e privuara nga liria nga ana e autoriteteve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse të Ministrisë së Drejtësisë janë pamundësia e akomodimit të grave në institucione që janë pranë komunitetit ku jeton familja e tyre, dhe aspekti i dytë lidhet me vendosjen e grave të paraburgosura dhe të dënuara në dy nga institucionet me një infrastrukturë tejet të amortizuara.

Të dyja këto institucione janë të lokalizuara në Tiranë, gjë që sjell vështirësi në mbajtjen e kontakteve të rregullta me familjen dhe të afërmit e grave, sidomos kur familjarët e tyre vijnë nga zona të largëta. Gjithashtu, për gratë e paraburgosura që vijnë nga rrethet e largëta u duhet të bëjnë rrugë të gjatë për të marrë pjesë në seanca gjyqësore të çështjeve të tyre penale. Këto aspekte ndikojnë negativisht tek ana psikologjike e grave.

Siç përmendet dhe më lart, mbeten problem kushtet infrastrukturore tejet të vjetruara të IP “Jordan Misja” dhe IEVP “Ali Demi” Tiranë ku janë vendosur gratë në dy sektorë të veçantë. Të dy sektorët janë pjesë e institucioneve ku akomodohen burrat e rritur dhe në institucionin e paraburgimit përveç burrave janë vendosur edhe të miturit e paraburgosur, sigurisht në sektorë të veçantë. Mjediset e banimit ku jetojnë gratë janë me lagështirë sidomos tek IP “Jordan Misja” dhe për të dyja institucionet këto dhoma nuk janë pajisur me tualete brenda. Jetesa e gjatë në të tilla ambiente sjell pasoja për shëndetin e grave të paraburgosura/dënuara që qëndrojnë aty. Megjithëse personeli i institucioneve siguron dezinfektim të tualeteve të përbashkëta të sektorit të grave, tek IP “Jordan Misja” gratë pohuan prezencën e ‘rregullt’ të minjve. Një situatë e tillë rrezikon seriozisht përhapjen e sëmundjeve të rënda për shëndetin e grave dhe vajzave që qëndrojnë aty.

IEVP “Ali Demi” ofron mjedise të hapura jashtë dhomave të banimit për gratë e dënuara ku kalojnë një pjesë të konsiderueshme të kohës së tyre gjatë ditës. Ndërsa në IP “Jordan Misja” mungojnë mjedise të tilla dhe për rrjedhojë, gratë i përjetojnë keq mjediset e mbyllura dhe të pamjaftueshme në këtë institucion.

Megjithëse në këta vite të fundit janë ndërtuar një numër i konsiderueshëm i institucioneve të reja penale me regjime paraburgimi dhe burgimi, në asnjë rast nuk i është dhënë përparësi ngritjes të një institucioni të veçantë për gratë e privuara nga liria. Ministria e Drejtësisë ka vendosur në strategjinë sektoriale të sajën ngritjen e institucioneve të reja të IP “Jordan Misja” dhe IEVP “Ali Demi”, por ende këto konsistojnë në projekte për t’u realizuar dhe mbetet për t’u vlerësuar nëse grave do t’u jepet një vëmendje e veçantë.

Infrastruktura ka rëndësinë e saj sidomos tek trajtimi i duhur i grave, por shumë më tepër rëndësi merr klima e sigurt që duhet garantuar tek institucionet ku janë të akomoduar gratë për të mundësuar një jetesë normale të tyre dhe jo thjesht mbijetesë. Me kënaqësi konstatojmë klima e mirë ekziston në të dy sektorët e grave në këto dy institucione.

Më konkretisht, ka një qasje aktive nga ana e personelit sa i takon ofrimit të aktivitete në këta sektorë, të cilat u vunë re se ishin më të larmishme dhe të shpeshta në IEVP ‘Ali Demi’, edhe për shkak të mundësive dhe hapësirave më të përshtatshme që ka ky institucion për realizimin e tyre dhe falë edhe kreativitetit të personelit për shfrytëzimin e këtyre hapësirave në maksimum.

Në këto institucione ofrohej një qasje e individualizuar e trajtimit të grave dhe vajzave të privuara nga liria, bazuar në nevojat e gjithsecilës. Institucionet në bashkëpunim me qendrat e formimit profesional dhe disa OJF që tashmë kanë kohë të gjatë që punojnë me këtë grup në nevojë, garantonin realizimin e disa kurseve profesionale, të pajisura me certifikata që njihen nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Gjithashtu, grave u ofrohej një gamë e gjerë aktiviteteve rikrijuese edhe sportive, sipas një programi ditor të mirë - përcaktuar. Sidomos tek IEVP ‘Ali Demi’ zhvillohen një larmi aktiviteteve, të cilat mbajnë të motivuara gratë e dënuara dhe rrisin mundësitë e kontakteve me shoqërinë jashtë burgjeve.

Në të dy institucionet ofrohet shërbim i mirë psiko-social i cili është pjesë e planit dhe trajtimit individual të secilës grua. Edhe më parë në këtë raport

është përmendur praktika e mirë e IEVP 'Ali Demi' ku për disa vjet me radhë funksionon sektori i kujdesit të veçantë që trajton gratë me probleme mendore. Në momentin e vëzhgimit në këtë institucion trajtoheshin dy gra të dënuara. Edhe pse në IP "Jordan Misja" mungon një sektor i kujdesit të veçantë, personeli i kujdesit social garanton një trajtim të diferencuar për gratë që kanë probleme të ndryshme mendore.

Kujdesi shëndetësor është një tjetër shërbim me rëndësi të veçantë për gratë. Ai duhet të ketë të njëjtat standarde si edhe në komunitetin jashtë institucioneve penale. Përgjithësisht u vu re një situatë e mirë e kujdesit shëndetësor në këto institucione, si në drejtim të rregullshmërisë së vizitave mjekësore, po ashtu sa i takon edhe kujdesit parandalues shëndetësor për këtë grup. Megjithatë, problem ngelej furnizimi me ilaçe, të cilat zëvendësoheshin nga institucionet me blerje të vogla. Situata pritej të përmirësohej me funksionimin e skemës shëndetësore për këto grupe.

Kontakteve me botën e jashtme u jepej rëndësia e duhur, nëpërmjet programeve të veçanta të hartuara dhe zbatuara nga personeli i kujdesit social për të mbajtur lidhjet me familjet dhe sidomos me fëmijët e grave. Gjithashtu, përgatitja për lirim ishte një aspekt me rëndësi i programeve psiko-sociale, por mbetet e njëjta problematikë e evidentuar edhe më lart në lidhje me mungesën e bashkëpunimit ndër-institucional mes aktorëve të ndryshëm shtetërorë dhe të shoqërisë civile. Megjithëse ka pasur raste kur autoritetet e burgjeve kanë ndërmarrë nisma për të futur gratë e dënuara në skema punësimi apo edhe përpjekje për arsimimin e tyre të mëtejshëm, ka pasur pak ose aspak vullnet për t'iu përgjigjur këtyre nismave nga ana e institucioneve përkatëse shtetërore. Duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj çështjeje KShH sugjeron përfshirjen e të gjithë aktorëve për të hartuar së bashku me personelin e institucioneve penale, programet individuale të përgatitjes për lirim të grave dhe për kthimin e tyre pranë familjes dhe komunitetit.

- **Sugjerime për përmirësimin e situatës**

Bazuar në gjetjet e monitorimeve të planifikuara, por edhe atyre sporadike, të nxitura nga ankesat që i janë drejtuar KShH nga personat me liri të kufizuar, që ndodhen në IEVP ose IP, kemi përpunuar disa sugjerime, me qëllim përmirësimin e situatës, të cilat i parashtrojmë më poshtë:

KShH e konsideron mbajtjen në burg të personave me masën “Mjekim të detyrues” si një shkelje të rëndë ligjore dhe vazhdimisht ka ngritur zërin për ta bërë evident këtë fakt. Në të gjitha raportet e monitorimit të burgjeve, të kryera nga subjektet shqiptarë dhe të huaj, është ngritur ky shqetësim, i cili mbart në vetvete probleme ligjore dhe institucionale. Kjo situatë, sigurisht, shkakton cenim të të drejtave të personave të sëmurë mendorë, të cilët në vend që të marrin mjekimin e detyrues ***në një institucion shëndetësor të specializuar, siç ka urdhëruar me vendim gjykata***, mbahen në burg, pa qenë të dënuar. Sërish, KShH u sugjeron institucioneve shtetërore përkatëse, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, të përshpejtojnë procedurat e kalimit të këtyre personave në institucione të veçantë shëndetësore, që do t’i trajtojnë këta pacientëve në përputhje me ligjin “Për shëndetin mendor”.

Siç është paraqitur edhe në raport, mbipopullimi kishte pësuar rritje, kryesisht në disa nga sektorët e paraburgimit. Ndaj sugjerojmë intensifikimin e përpjekjeve, të strukturave përgjegjëse shtetërore, siç janë DPB, Gjykatat, Prokuroria dhe Shërbimi i Provës, që të studiojnë situatën dhe të gjejnë instrumente, për ta përmirësuar mbipopullimin në mënyrë të qëndrueshme dhe të synohet drejt një politike penale të zhdërvjellët, me qëllim uljen e mbipopullimit.

Grupeve në pozita të dobëta duhet t’u ofrohet një trajtim më i specializuar, i bazuar në nevojat e tyre të veçanta. Më shumë vëmendje duhet t’u kushtohet me të miturit, përdorimit të metodave pedagogjike, për disiplinimin e sjelljeve të tyre anti-sociale në institucionet e paraburgimit. Përdorimi i këtyre metodave do të nxisë tek të miturit: a) sjelljet pozitive sociale; b) do të rrisë bashkëpunimin e miturve për zbatimin e programit ditor; c) do të shmang rrezikun e përdorimit të formave të ushtrimit të dhunës fizike apo psikologjike.

KShH sugjeron që personeli i institucioneve, ku mbahen të mitur, duhet të pajiset me njohuri dhe aftësi praktike në përdorimin e metodave pedagogjike U-Turn dhe Equip, të cilat janë sjellë si praktikë pilot në institucionin e të miturve Kavajë.

Puna në sektorët e kujdesit të veçantë duhet të ketë qasje individuale dhe trajtim multi-disiplinor ku, krahas trajtimit mjekësor psikiatrik, rëndësi të madhe merr trajtimi psiko-social, terapeutik, punësimi okupacional dhe sportet e lehta, sipas specifikave të pacientëve. Puna në ekip, duke përfshirë të gjithë sektorët që punojnë me këtë grup, do të sillte rezultate konkrete për përmirësimin e gjendjes së tyre shëndetësore.

Duke pasur këtë qasje individuale dhe multi-disiplinore, KShH tërheq vëmendjen e IP Durrës dhe QSB, të fillojnë menjëherë nga puna për realizimin e këtij trajtimi ndaj pacientëve. Edhe IEVP Krujë, pavarësisht disa masave pozitive, të kohëve të fundit, për përmirësimin e programit ditor, duhet t'i kushtojë vëmendje më të madhe përmirësimit të trajtimit të personave me probleme të shëndetit mendor. Qëndrimi pasiv i këtyre pacientëve nëpër dhoma gjatë gjithë ditës, duke mos u ofruar një program trajtimi të larmishëm, bazuar në nevojat e tyre specifike, është shkelje e kërkesave ligjore kombëtare dhe standardeve ndërkombëtare.

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë duhet të marrin masa të menjëhershme lidhur me garantimin e trajtimit psikiatrik të personave të privuar nga liria, me probleme të shëndetit mendor, që janë në institucione të ndryshme penale, me qëllim që ata të trajtohen me të njëjtin standard mjekësor me pacientët që kurohen në institucionet shëndetësore. Gjithashtu, duhet zgjidhur mbingarkesa e mjekut psikiatër në QSB duke bërë një planëzim më të mirë të ngarkesës me punë i mjekëve psikiatër, që kanë në dispozicion IEVP-të dhe plotësim të organikave në institucionet e veçanta ku numri i këtyre pacientëve është i konsiderueshëm.

Megjithëse janë vënë re zhvillime pozitive në mospërdorimin e prangave si mjet i kufizimit të pacientëve në krizë në QSB, KShH sugjeron aplikimin e procedurave të reja për mënyrën e administrimit të kufizimit të pacientët, që ka hartuar Ministria e Shëndetësisë, në zbatim të ligjit "Për shëndetin

mendor”. Këto procedura shmangin mundësitë e abuzimit me pacientët në momente krize dhe mundësojnë nxjerrjen e përgjegjësisë së stafit që abuzon në këtë drejtim.

KShH evidenton nevojën e trajnimeve të vazhdueshme multi-disiplinore të personelit që punon me personat me probleme të shëndetit mendor në I.E.V.P dhe I.P. Hapja e sektorëve të kujdesit të veçantë në institucionet ku ka një numër të konsiderueshëm të personave të privuar nga liria, me probleme të shëndetit mendor, mbetet një masë e domosdoshme që duhet marrë, sa më shpejt. Sugjerohet të ndiqet praktika e mirë e zbatuar në I.E.V.P. Ali Demi, në sektorin e grave.

Gjatë vëzhgimeve në lidhje me trajtimin e grave të paraburgosura dhe ato të dënuara u vunë re shumë aspekte pozitive, por është për të ardhur keq që gratë vazhdojnë ende të akomodohen në institucione tejet të amortizuara nga ana infrastrukturore. KShH ri-përsërit sugjerimin për vendosjen e grave në institucione që i përgjigjen nevojave të tyre të veçanta.

Siguria dhe të ndjerit të sigurt në institucionet penitenciare përbën bazën e domosdoshme për respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria dhe mirë-funksionimin e institucioneve penale. Ndaj, KShH sugjeron, që çdo pretendim për ushtrim të dhunës fizike apo psikologjike nga personeli, ose edhe në mes vetë të dënuarve, duhet të merren në shqyrtim menjëherë dhe me shumë kujdes nga autoritetet përkatëse shtetërore, me qëllim vënien para përgjegjësisë të çdokujt që ushtron dhunë mbi të burgosurit. Në mënyrë të veçantë nuk duhen toleruar vonesat në ekzaminimin mjekësor të të burgosurve/ paraburgosurve që pretendojnë të jenë dhunuar, ose që pësojnë dëmtime fizike, nga çdo lloj shkaku, si dhe dokumentimin e mjekimit të kryer me këtë rast.

Megjithëse vitet e fundit janë marrë masa për përmirësimin e infrastrukturës së institucioneve penitenciare, KShH sjell në vëmendjen e autoriteteve të burgjeve se ka nevojë për të përmirësuar situatën më tej, veçanërisht, për pajisje të ndryshme për fjetje, largimin e lagështirës si dhe duhen evituar mungesat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë, tek të gjitha institucionet e evidentuara në këtë raport vëzhgimi.

Duke marrë shkas nga problemet që janë evidentuar nga vëzhgimet lidhur me mbajtjen dhe trajtimin e personave në dhomat e veçimit, të cilët nuk kanë marrë masa disiplinore, KShH sugjeron hartimin e udhëzuesve të veçantë për këto situata dhe DPB të menaxhojë më mirë nevojat për transferimin e te burgosurve/paraburgosurve që kanë probleme të përshtatshmërisë që në institucionet ku janë sistemuar. Gjithashtu për personat që propozohen për masë disiplinore duhet siguruar, në çdo rast, të zbatohen procedurat disiplinore me korrektesë, pa vonesa dhe duke respektuar parimin e proporcionalitetit në caktimin e masës.

KShH sugjeron intensifikimin e punës lidhur me programet e përbashkëta të përgatitjes për lirim të të dënuarve, veçanërisht për të miturit dhe gratë. Strukturat përgjegjëse shtetërore si shërbimi i provës, përfaqësuesit e zyrave vendore të arsimit, punësimit, komunave dhe bashkive, si dhe shërbimet e dhëna nga OJF-të e ndryshme duhet të bëhen pjesë e programit të marrjes së masave për të mundësuar një kthim të suksesshëm në shoqëri të të dënuarve.

KShH sugjeron sigurimin e burimeve financiare dhe njerëzore të mjaftueshme për zhvillimin e programeve të nevojshme për trajtimin e të burgosurve, të cilat të përfshijnë mundësitë për aktivitete të përshtatshme të vazhdueshme edukative dhe arsimore.

Së fundi, KShH dëshiron të theksojë rëndësinë e madhe që ka rritja e vazhdueshme profesionale e personelit në institucionet penitenciare. Një personel profesional përbën garanci për respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria dhe mbarëvajtjen e mirë të punës në këto institucione. Gjithashtu, qëndrueshmëria e personelit të trajnuar merr rëndësi të veçantë për garantimin e shërbimeve cilësore në institucion. Inkurajojmë DPB-në të zhvillojë më tej politikat e përzgjedhjes së personelit në sistemin e burgjeve, bazuar mbi meritokracinë, si dhe të aplikojë politika që garantojnë trajnim vazhduesh, qëndrueshmëri dhe kushte të pranueshme të punës për personelin, duke parë mundësinë e rritjes së fonde që planifikohen në këtë drejtim.

Pjesa II

**SITUATA NË DREJTORITË
DHE KOMISARIATET E POLICISË**

Prej vitesh KShH vëzhgon situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në institucionet e privimit të lirisë, ndër to edhe në drejtoritë dhe komisariatet e policisë në vend. Siguria publike është thelbësore për funksionimin e mirë të shoqërisë, por nga ana tjetër, strukturat e policisë duhet të ushtrojnë funksionet e tyre në respektim të plotë të të drejtave të personave të privuar nga liria. Duke pasur parasysh këtë mision të dyfishtë të Policisë së Shtetit, KShH evidenton në këtë raport nevojën e vazhdueshme të vigjilencës në respektim të të drejtave të personave që përballen me policinë e shtetit.

KShH dëshiron të theksojë se, në përvojën e tij, periudha menjëherë pas ndalimit/arrestimit/shoqërimit përbën rrezikun potencial për ushtrim presioni psikologjik dhe/ose për keqtrajtime fizike dhe verbale. Ndaj dhe respektimi i të drejtave dhe trajtimi i personave të privuar nga liria në përputhje me ligjin nga ana e policisë së shtetit, është garanci përkundrejt çdo lloj forme të mundshme të abuzimeve.

METODOLOGJIA

Gjatë periudhës Maj - Nëntor 2012, KShH realizoi misione monitorimi në disa nga drejtoritë dhe komisariatet e policisë së vendit tonë. Më konkretisht u vëzhguan komisariatet e policisë në Krujë, Vlorë, Durrës, Tepelenë, Gjirokastër, Korçë, Shkodër, Lezhë, në komisariatet Nr. 2, Nr. 3, Nr. 4 dhe Nr. 5 në Tiranë. Monitorimi në komisariatet e policisë Nr. 3 në Tiranë është kryer në bashkëpunim me Avokatin e Popullit.

Qëllimi i këtij raundi vëzhgimesh ishte vlerësimi i situatës së të drejtave të shoqëruarve, të ndaluarve dhe të arrestuarve në drejtoritë dhe komisariatet e policisë, me fokus të veçantë trajtimin e grupeve në pozita të dobëta në këto institucione të privimit të lirisë. Vëzhgimet u realizuan nga vëzhgues me përvojë të KShH-të profesioneve të ndryshme si juristë, mjekë të specialiteteve të ndryshme, psikologë dhe punonjës socialë.

Duke e vlerësuar me seriozitetin e duhur procesin e vëzhgimeve në këto institucione të mbyllura, KShH ka trajnuar vëzhguesit e tij paraprakisht, duke i pajisur ata me njohuri të përditësuara për problematikën në kuadrin

teorik dhe praktik, nxjerrë nga raportet e tij dhe të aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë që veprojnë në këtë fushë, po ashtu për specifikat dhe trajtimin e grupeve në pozita të dobëta, për standardet ndërkombëtare të monitorimit parë nga këndvështrimi i zbatimit në praktikë, për parimet e metodologjisë së vëzhgimit dhe të raportimit, si dhe i ka pajisur ata me pyetësorët e monitorimit²⁰. Grupe me minimalisht 2 vëzhgues kanë vizituar institucionet e vëzhguara, gjetjet e të cilëve janë prezantuar zyrtarisht përfaqësuesve, edhe nëpërmjet komunikimeve zyrtare.

Gjatë vëzhgimeve u mbajtën parasysh standardet, të drejtat dhe rregullimet e përcaktuara në legjislacionin shqiptar, më konkretisht në: Kushtetutën e RSH-së; Kodin penal; Kodin e procedurës penale; ligjin nr. 9331, datë 21.04.1998, ndryshuar me ligjin nr. 10024, datë 27.11.2009, 'Për ekzekutimin e vendimeve penale'. U mbajtën parasysh, gjithashtu, rekomandimet e KPT-së të KE për Shqipërinë, të Avokatit të Popullit dhe të KShH-së.

Ky raport paraqet problemet më të rëndësishme dhe më të përgjithshme të konstatuara në institucionet e vëzhguara gjatë kësaj periudhe. KShH dëshiron të falënderojë strukturat drejtuese të Policisë së Shtetit për lehtësimin dhe aksesin e mundur gjatë kryerjes së vëzhgimeve. Përgjithësisht, vëzhguesve të KShH-së u është mundur akses në këqyrjen e ambienteve fizike dhe intervista me personat e shoqëruar / ndaluar / arrestuar duke u mundur ruajtjen e konfidencialitetit.

- **Gjetje nga situata e vëzhguar në terren**

Gjatë këtij raundi vëzhgimesh, KShH i ka kushtuar rëndësi të veçantë trajtimit të grupeve në pozita të dobëta që gjenden në ambientet e komisariateve të policisë. Fokusi kryesor kanë qenë grupet e të miturve,

²⁰ Vëzhguesit kanë intervistuar të gjithë personat e gjetur në momentet e vëzhgimit në drejtoritë dhe komisaritet e policisë sipërpërmendur, si dhe kanë intervistuar po ashtu personelin përgjegjës të policisë, të caktuar për këtë punë.

grave dhe rastet e menaxhimit të personave me probleme të shëndetit mendor në këto institucione.

Nga monitorimi i kryer në institucionet e vëzhguara u gjet se kishte dhoma të veçanta, rezervuar për të miturit dhe gratë, çka vlerësohet si aspekt pozitiv dhe tregon për një ndjeshmëri në rritje kundrejt trajtimit të këtyre grupeve në pozita të dobëta. Megjithatë, në një rast (në komisariatit Nr. 3 Tiranë) është konstatuar se, ndonëse kishte dhoma të rezervuara për mbajtjen e të miturve, ato nuk ishin përdorur në momentin kur dy të mitur gjendeshin në këtë komisariat në cilësinë e të shoqëruarit. Po ashtu, shërbimi i psikologut në shumicën e rasteve ofrohet vetëm nëse këta të mitur do të ndaloheshin dhe jo gjatë fazës së shoqërimit të tyre.

KSHH-ja ndoqi e shqetësuar rastin flagrant të një të mituri ndaj të cilit u ushtrua dhunë fizike nga një punonjës policie. Ky rast u evidentua përmes pamjeve filmime televizive në fund të muajit nëntor 2012. Rasti në fjalë është ndjekur më tej nga Avokati i Popullit pranë organeve të prokurorisë. KSHH duke marrë shkas nga ky rast, tërheq vëmendjen e autoriteteve të policisë të parandalojnë këto shkelje të rënda të të drejtave personave të privuar nga liria, aq më tepër kur subjekt i ushtrimit të dhunës bëhet i mituri. Në rastet kur këto raste fatkeqësisht ndodhin, duhet të jenë strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit ato që të distancohen dhe procedojnë penalisht shkelësit e ligjit.

Sa i takon trajtimit të grave dhe vajzave të shoqëruara/ndaluara/arrestuara konstatojmë se përgjithësisht kemi rritje të ndërgjegjësimit për trajtimin e veçantë të tyre. Kjo vihet re tek krijimi i ambienteve të veçanta si dhe tek shtimi i organikës së personelit të këtyre institucioneve me personel femër. Në ato komisarate ku nuk kishte personel femër, gratë e shoqëruara/ndaluara/arrestuara i transferonin në drejtoritë përkatëse të policisë ku ofrohej ky shërbim.

Personat me probleme të shëndetit mendor përbëjnë një grup në pozita dobëta, të cilët potencialisht janë një grup i vështirë për t'u menaxhuar në mënyrë profesionale dhe pa pasoja të dëmshme për ta nga strukturat e policisë së shtetit. Nga vëzhgimet vihet re një mosnjohje në shkallë të lartë

të veçorive apo simptomave që paraqesin të tillë persona të sëmurë. Shpesh sjellja e tyre nuk kuptohet si e tillë, çka sjell edhe një trajtim jo të duhur në përputhje me nevojat e këtij grupi personash të sëmurë. Gjithashtu, stigma dhe paragjykimet²¹ që kanë punonjësit e policisë për këta persona ishin të larta. Duhet thënë gjithashtu se u vu re një bashkëpunim i mirë me spitalet psikiatrike, në rastet kur ata shoqëroheshin nga policia.

Personat e shoqëruar/ndaluar/arrestuar duhet të informohen shprehimisht dhe pa vonesë për të gjitha të drejtave të tyre kur shoqërohen/ndalohen/arrestohen nga organet e policisë. KShH i kushton shumë rëndësi këtij momenti, sepse ai ka të bëjë drejtpërdrejt me respektimin e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria, siç janë e drejta e aksesit të menjëhershëm tek një avokat, e drejta për të njoftuar familjen apo të afërmit (sidomos nëse bëhet fjalë për të miturit, ky është detyrim ligjor), e drejta për të kryer ekzaminime mjekësore në rast nevojë etj.. Duke bërë prezent këto të drejta nga punonjësit e policisë, i është dhënë një garanci më shumë shtetasit në fjalë për respektimin dhe trajtimin e tyre sipas ligjit.

Nga vëzhgimi në terren ka rezultuar se në shumë raste personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar nuk u bëhen prezent të drejtat e tyre që në momentin e parë të përballjes me policinë e shtetit. Shumë të intervistuar pohuan se fillimisht iu ishte thënë që thjesht do të shoqëroheshin në komisarariat. Më tej, këto të drejta iu bëheshin prezent nga oficerët e policisë gjyqësore, në momentin e marrjes në pyetje.

Ka disa kohë që ka nisur një praktikë e mirë e dhënies në mënyrë të shkruar së këtyre të drejtave çdo personi që shoqërohet apo ndalohet nga policia. Kjo është një deklaratë individuale në të cilën u kërkohet personave në fjalë të nënshkruajnë për të treguar se kanë marrë dijeni për to. Në praktikë kemi vërejtur që jo në të gjitha institucionet e vëzhguara jepej kjo deklaratë, pavarësisht se njihej si procedurë. Në komisariatin

²¹ Në intervistat me punonjësit e policisë për këtë grup, shpesh ata i referoheshin si ‘budallenjtë’ apo ‘të çmendurit’.

Tepelenë, komisariatet Nr. 4 dhe Nr 3 në Tiranë ende nuk kishte filluar të zbatohesh.

Të pyetur nëse e njihnin këtë deklaratë, shumica e personave të shoqëruar/ndaluar nuk ishin të vetëdijshëm për marrjen e këtij dokumenti²². Kështu, theksojmë se, krahas dhënies formale të deklaratës personave të shoqëruar/ndaluar u duhet bërë me dije, në atë mënyrë që ata ta kuptojnë përmbajtjen e saj, për ta bërë këtë procedurë realisht efektive.

KSHH përgëzon faktin që posterat me të drejtat dhe detyrimet e personave të shoqëruar, ndaluar, arrestuar u gjetën në të gjitha ambientet e komisariateve të policisë të vëzhguara. Megjithatë, jo në të gjitha këto institucione, ky informacion ishte i mundshëm për tu marrë nga personat e shoqëruar/ndaluar/arrestuar, për shkak të pozicionit të vendosjes së tyre.

Afatet procedurale²³, të mbajtjes në institucionet policore të personave të ndaluar/arrestuar, përgjithësisht ishin kuptuar drejt dhe kahja e përgjithshme ishte që ato tentoheshin të respektoheshin, por KSHH ka gjetur edhe raste në terren, kur këto afate ose nuk respektoheshin, ose ishin kuptuar ndryshe. Në komisariatin Nr. 5 Kamëz, Tiranë, u gjetën 2 persona që mbaheshin aty përtej çdo afati ligjor të përcaktuar²⁴. Drejtuesit e institucionit ishin të vetëdijshëm për situatën dhe konfirmuan se kishin probleme edhe me transferimin e personave në ambientet e paraburgimit,

²² Thuahejse të gjithë personat e shoqëruar/ndaluar të pyetur nga vëzhguesit e KSHH-së, për faktin se sa e njihnin një deklaratë të shkruar me të drejtat e tyre, ata u përgjigjën me “jo”, ndërkohë që e kishin me vete atë dokument por të pavetëdijshëm që ky dokument i njihte me të drejtat e tyre në momentin e ndalimit nga policia.

²³ Siç parashikohen në nenin 28, të Kushtetutës së RSHH “... 2. Personi, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi c, duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirinë e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim... 4. Në të gjitha rastet e tjera, personi, të cilit i hiqet liria në rrugë jashtëgjyqësore, mund t’i drejtohet në çdo kohë gjyqtarit, i cili vendos brenda 48 orëve për ligjshmërinë e kësaj mase.”

²⁴ Në Komisariatit Nr. 5 në Tiranë (Kamëz) një person i ndaluar kishte 7 ditë, ndërsa një tjetër person i ndaluar kishte 5 ditë qëndrimi në këto ambiente, ndërsa në komisariatit Shkodër, si rregull të ndaluarit mbaheshin nga 4 ditë në këto ambiente.

vonesa këto që krijoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB). Ndërsa në komisariat Shkodër, u konstatua zbatimi i praktikës së mbajtjes së personave të ndaluar/arrestuar, si rregull maksimalisht deri në 96 orë. Nga këqyrja e regjistrave përkatës, u vu re se një numër i lartë personash të ndaluar që qëndronin në këtë komisariat mbaheshin 4 ditë. Kjo na u konfirmua edhe nga dy prej të ndaluarve që ishin aty, përkatësisht me inicialet K. SH. dhe B. B. të cilët ishin në institucion prej 4 ditë e gjysmë.

Sa i përket shërbimit mjekësor që ofrohet në këto institucione, vihen re standarde të dyfishta. Në drejtoritë e policisë, ka mjek i cili asiston me ndihmë mjekësore, ndërsa në komisaritet e policisë nuk ofrohet një shërbim i tillë. Në raste nevojë, të ndaluarit shoqëroheshin për në spitalin më të afërt. Gjithashtu, u vërejtën mungesa të mëdha në medikamente mjekësore, si dhe pajisje të tjera të nevojshme për këtë shërbim. Përgjithësisht, nga vëzhgimet u vu re se mbështetja këtyre institucioneve për ndihmë mjekësore u vinte më shumë nga spitalet civile sesa nga shërbimi i brendshëm mjekësor i tyre.

KSHH dëshiron të sjellë në vëmendjen e autoriteteve drejtuese të DPPSH dhe të institucioneve në varësi të saj, rastin e një të ndaluarit me inicialet F. D. i cili kishte 7 ditë që qëndronte në Komisaratin Nr. 5, Kamëz. Ky person ishte diagnostifikuar si person Albin, i cili nuk ishte vizituar nga mjeku i institucionit. Për arsye sigurie personeli i kishte marrë syzet optike, pa të cilat ai kishte mundësi shumë të pakta shikimi, për shkak të specifikës mjekësore të sëmundjes së tij²⁵. Ai kishte disa ditë që ia kërkonte syzet autoriteteve të këtij institucioni, por ato i mohoheshin për arsye sigurie.

KSHH sugjeron që të tilla raste të shqyrtohen me vëmendje maksimale nga strukturat përkatëse të DPSSH, dhe të parandalohen situata të cilat vështirësojnë jetesën dhe mirëqenien e personit të privuar nga liria. Kohëzgjatja e jashtëligjshme e mbajtjes së tij në këto ambiente, të cilat nuk plotësonin standardet minimale të trajtimit, duke i “penguar” atij edhe shikimin, përbëjnë keqtrajtim dhe trajtim degradues.

²⁵ Ky i ndaluar kishte miopi të shkallës së dytë.

Marrja në pyetje e të ndaluarve/arrestuarve është një tjetër aspekt në interes të këtyre vëzhgimeve. Kjo është një procedurë që duhet të udhëhiqet nga parimit i prezumimit të pafajësisë, si dhe duhet të menaxhohet me profesionalizëm të lartë, korrektësi dhe paanësi. Duke qenë një moment i rëndësishëm, gjatë marrjes në pyetje duhet të mbahen parasysh procedura të qarta²⁶, si dhe duhet të kryhet gjithmonë në prani të avokatit të personit. Në rastin e personave të mitur, është detyrim ligjor, prezenca e familjarit apo e kujdestarit.

Nga vëzhgimi u konstatua se përgjithësisht, personat e shoqëruar, merreshin në pyetje në shumicën e rasteve pa prezencën e avokatit të personit. Ndërsa kur personi ndalohej, përgjithësisht përfshihej në proces avokati i tij, kjo për arsyen se, në rast të mungesës së tij, gjykata i konsideronte të pavlefshme veprimet procedurale. Përgjithësisht, edhe sa i takon rasteve të të miturve të shoqëruar / ndaluar është vënë re e njëjta situatë.

Më konkretisht, nga vëzhgimet e KSHH-së në komisariatit Nr. 3 Tiranë, janë gjetur dy persona të mitur të shoqëruar më inicialet K.S dhe Zh.S të cilët ishin në të njëjtën dhomë me dy të rritur, pavarësisht se në komisariat kishte dhoma të veçanta për këtë grup. Problem shqetësues ishte gjithashtu fakti se këta të mitur ishin shoqëruar në komisariat për qëllime investigimi, për të identifikuar një person të tretë të përfshirë në hetim²⁷. Fakt tjetër shqetësues ishte se në regjistrin e shoqërimit, ishte shënuar si arsye e shoqërimit mungesa e dokumenteve të identifikimit, ndërkohë që të dy të miturit kishin me vete kartat e identitetit.

KSHH i ka kushtuar rëndësi edhe regjistrimit elektronik (sistemi ADAMS) të të dhënave të personave që shoqërohen/ndalohen/arrestohen. Thuajse në të gjitha institucionet e vëzhguara, të dhënat përkatëse nuk hidheshin

²⁶ Për të shmangur keqtrajtimet apo presionet e mundshme gjatë procesit të marrjes në pyetje, KPT ka sugjeruar vendosjen e kamerave audio dhe video në këto ambiente.

²⁷ Sipas autoritetit zyrtar të këtij komisariati, të miturit mbaheshin në të njëjtën ambient me të rriturit, sepse duhet të identifikonin një person të tretë, të kapur bashkë me ta.

menjëherë në këtë sistem. Gjithashtu, në shumicën e institucioneve të vëzhguara ky sistem nuk funksiononte siç duhej, por shpeshherë dilte jashtë funksionit.

Një nga përgjegjësitë e personelit policor në ambientet e policisë është dhe sigurimi i integritetit fizik dhe psikologjik të personave nën kujdesin e tyre. Një nga garancitë në këtë aspekt është edhe funksionimi i mekanizmit të kërkesë- ankesës²⁸. KShH ka lobuar fuqishëm që e drejta e ankesës dhe kërkesës të sanksionohet në ligjin për Policinë e Shtetit. DPSSH ka ngritur një grup pune ku edhe KShH bën pjesë për rishikimin e ligjit në fjalë. Në këtë proces shumë dispozita ligjore janë përmirësuar parë nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut përfshirë edhe garantimin ligjor të së drejtës së kërkesës dhe ankesës. KShH sugjeron që përmirësimet ligjore të ligjit për Policinë e Shtetit të finalizohen sa më shpejt. Paralelisht me këtë zhvillim, DPSSH ka hartuar një model të regjistrit të kërkesë-ankesës, të cilin e ka shpërndarë në institucionet në varësi të saj²⁹.

Nga vëzhgimi konstatojmë se në pak institucione policore ky regjistër kishte filluar të plotësohej. Në institucionet e tjera, ose kishte filluar të plotësohej gabim (për arsye të moskuptimit të drejtë të mënyrës apo funksionimit të tij, siç ishte rasti në komisariatin Nr. 5 në Kamëz), ose nuk ishte futur fare në funksion (si në rastin e komisariatit të policisë në Durrës etj.).

Praktika ka treguar se personat e shoqëruar/ndaluar/arrestuar qëndrojnë në ambientet e policisë, përgjithësisht në afatet maksimale ligjore, ndonëse parimi udhëheqës duhet të jetë i kundërti. Koha e qëndrimit në këto ambiente duhet të jetë sa më e shkurtër. Duke qenë se aty mbahen të shoqëruar/ndaluar/arrestuar për disa ditë, kushtet fizike të ambienteve të qëndrimit duhet të plotësojnë disa parametra të caktuar fizikë dhe

²⁸ KShH ka publikuar një raport vlerësimi sa i takon funksionimit të këtij mekanizmi në institucionet policore, në të cilin janë prezantuar gjetjet konkrete dhe sugjerimet për përmirësimin e situatës.

²⁹ KShH ka dhënë mendimet e tij për këtë regjistër.

materialë. Të tilla janë: hapësira fizike e dhomave³⁰, ndriçimi i përshtatshëm artificial dhe natyral, ventilimi apo ngrohje, pajisjet si karrige fikse apo stola fiks, shtrat për person, shtroje të pastra personale, kushte për mbajtjen e higjienës personale, duke përfshirë mundësinë për të bërë dush etj.

KShH konstaton se ka një tendencë dhe angazhim praktik për të përmirësuar kushtet fizike të ambienteve të shoqërimit/ndalimit nga ana e strukturave drejtuese të policisë së shtetit. Kjo si pasojë edhe e presioneve të vazhdueshme nga organizata ndërkombëtare dhe kombëtare për të përmirësuar situatën. Gjithashtu, KShH ka vërejtur se në disa komisariate policie, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, janë nxjerrë jashtë funksionit ambientet e shoqërimit apo ndalimit për shkak të mos përmbushjes së standardeve minimale të trajtimit (si në komisariatin e policisë Tepelenë, komisariatin Nr. 4 Tiranë etj.). KShH e vlerëson pozitivisht këtë qëndrim të policisë së shtetit, në garantim të respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e policisë së shtetit.

Përveç ambienteve të komisariateve Gjirokastrë, Korçë, Tepelenë (ambientet e shoqërimit) dhe Lezhë, të cilat plotësonin kushtet minimale të mbajtjes dhe trajtimit, konstatohet se situata konkrete në ambientet e ndalimit të drejtorive dhe komisariateve të Vlorës, Durrësit, Shkodër, komisariatit Nr. 4, Nr. 5, Nr. 3 në Tiranë nuk plotëson standardet e mbajtjes dhe trajtimit të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar në kujdesin e tyre. Këto ambiente ishin të vogla në kubaturë, pa ndriçim natyral apo artificial të mjaftueshëm, pa ventilim, pa tualete brenda, me shtroje të vjetruara, të papastra dhe jo personale³¹ etj.. Të pyetur nga KShH, asnjë nga personat e ndaluar/arrestuar nuk kishte bërë dush gjatë kohës së qëndrimit aty. Gjatë vëzhgimeve pati edhe ankesa për pengesa të aksesit në tualet pa sidomos gjatë natës.

³⁰ Standardi minimal i KPT-së për këtë hapësirë është 7 metra², 2 metra ose më shumë gjerësi, 2.5 metra lartësi.

³¹ Personat nuk pajiseshin me shtroje (çarçafë, batanije) të pastra personale kur hynin në institucion, por përdornin ato që gjenin nëpër dhoma.

Mbajtja e të ndaluarve/arrestuarve në të tilla ambiente, përbën në vetvete keqtrajtim dhe trajtim degradues. Veçanërisht ambientet e komisariatit të Vlorës, komisariatit Nr. 3 dhe Nr. 5 Kamëz, Tiranë, linin shumë për të dëshiruar në këtë aspekt, duke mos përmbushur asnjë nga standardet e lartpërmendura.

Në të shumtën e herës, personeli drejtues i këtyre institucioneve ishte i vetëdijshëm për kushtet e këqija të këtyre ambienteve, por në disa raste ata justifikonin të tilla kushte me 'argumente'³² të ndryshme. Ata gjithashtu pohuan se e kishin bërë prezent këtë situatë, si dhe kishin kërkuar nga strukturat e DPPSH për alokimin e fondeve për t'i rikonstruktuar këto ambiente bazuar në standardet e pranuar në këtë fushë. Disa prej këtyre institucioneve ishin në proces rikonstruksioni të ambienteve të shoqërimit/ndalimit (si komisariati Durrës, apo siç kishte në plan të afërt komisariati Vlorë), ndërkohë që ambientet e punës së personelit ishin rikonstruktuar kohë më parë.

E drejta e njoftimit të familjarëve apo të afërmeve të personave të shoqëruar/ndaluar, apo arrestuar është një tjetër e drejtë e garantuar me ligj, sidomos për të miturit zbatimi i kësaj të drejte merr rëndësi të veçantë. Përgjithësisht, është gjetur që familjarët apo të afërmit e tyre janë njoftuar për gjendjen e familjarëve/të afërme të tyre në ambientet policore. Kjo nuk bëhej që në momentet e para të shoqërimit apo ndalimit, por me kalimin e disa orëve të qëndrimit aty. Shpesh punonjësit e policisë angazhoheshin edhe me mjetet e tyre private të komunikimit³³ për të realizuar këtë të drejtë. Megjithatë, duhet të sjellim në vëmendje rastin e përmendur më lart, të shoqërimit të dy të miturve në komisariatin Nr. 3 Tiranë, gjatë orëve të natës. Familjarët e njërit prej këtyre të miturve nuk ishin njoftuar për shoqërimin e tij, sepse vetë i mituri nuk kishte dashur t'i

³² Në konstatim të mungesës së stolave për t'u ulur qoftë në dhomat e shoqërimit apo ndalimit në komisariatit Shkodër, të cilat ishin pa asgjë brenda, drejtuesit që na shoqëronin e justifikuan "s'ka nevojë për to".

³³ Kjo për shkak të burimeve të mjaftueshme financiare për blerjen e kartave të telefonisë fikse nga institucionet.

njoftonte. Sipas nenit 35³⁴ të Kodit të Procedurës Penale është detyrim ligjor njoftimi i familjarëve të të miturve që mbahen në ambiente policore.

E drejta e ajrimit për personat e ndaluar/arrestuar/dënuar nuk respektohej në asnjë institucion të vëzhguar. KShH tërheq vëmendjen e autoriteteve të policisë që e drejta për ajrim është një e drejtë ligjore dhe për rrjedhojë duhen marra masa imediate që për të gjithë personat e privuar nga liria që mbahen në mjediset e komisaritit të policisë duhet t'u mundësohet çdo ditë ajrimi siç e garantojnë standardet ndërkombëtare.

Nga vëzhgimet në disa institucione u vërejtën mungesa të personelit, të cilat ishin në proces plotësimi (institucionet kishin bërë kërkesat për shtesë në organikë). Gjithashtu, nga vëzhgimet u vu re se në strukturat organike kishte një pozicion pune si juristi/psikolog. KShH sugjeron rishikimin e këtij pozicioni pune të organikës së institucioneve, duke e i ndarë pozicionet e punës së juristit dhe psikologut, si profesione të ndryshme. Garantimi i shërbimeve të tilla në mënyrë efektive kontribuon në respektimin më të mirë të të drejtave të personave të privuar nga liria.

Gjatë vëzhgimeve u vunë re vonesa në nxjerrjen e urdhrit për ekzekutim nga prokurori, për transferimin e personave në institucionet penale. KShH për të disatën herë e ngre këtë çështje duke tërhequr vëmendjen e organit të prokurorisë për të vepruar shpejt për të shmangur qëndrimet e personave të dënuar përtej afateve ligjore, fakt i cili përbën shkelje ligjore të të drejtave të personave të privuar nga liria.

Një tjetër problem i konstatuar në thuajse të gjitha komisaritet e policisë që mbanin persona të arrestuar (të dënuar me vendim të formës së prerë, persona në kërkim), ndaj të cilëve kishte dalë urdhri i ekzekutimit të

³⁴ “Pika 1. Të pandehurit të mitur i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që procedon.

2. Organi procedues mund të kryejë veprime dhe të përpilojë akte, për të cilat kërkohet pjesëmarrja e të miturit, pa praninë e personave të treguar në paragrafin 1, vetëm kur një gjë e tillë është në interes të të miturit ose kur vonesa mund të dëmtojë rëndë procedimin, por gjithmonë në praninë e mbrojtësit.”

vendimit penal nga prokurori, ishte mbajtja e tyre jashtë afateve të përcaktuara ligjore. Në momentin që këta persona kapeshin, dërgoheshin nëpër komisaritet e policisë, ku autoritetet përgjegjëse duhet të ndërmerrnin një procedurë burokratike të gjatë, duke ju drejtuar DPB-së për të filluar procedurat e transferimit. Të tillë persona mbaheshin deri në 12 ditë në ambientet policore, deri në përcaktimin nga DPB të vendit të ekzekutimit të vendimit penal. E tillë procedurë bie në kundërshtim me ligjin, duke shkelur të drejtat e personave të dënuar, si edhe sjell mbipopullim artificial të komisariateve të policisë.

Dy problemet e fundit të ngritura në këtë raport tregojnë se ka nevojë të përmirësohet ndjeshëm bashkëpunimi midis strukturave policore, të gjykatës, prokurorisë dhe atyre të burgjeve, për të shmangur vonesat e transferimeve të personave në burgje.

Ky raund vëzhgimesh u fokusua edhe në nevojat e strukturave të policisë së shtetit për kryerjen në mënyrë profesionale dhe të bazuar në ligj të punës së tyre. Nga intervistat me personelin policor të institucioneve të vëzhguara u theksua më së shumti nevoja të bazës materiale si dhe të rritjes së mëtejshme të profesionalizmit të punonjësve të policisë.

- **Sugjerime për përmirësimin e situatës**

KShH vlerëson ndryshimet pozitive të ndërmarra nga strukturat e policisë në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës apo të plotësimit të personelit, të hapjes së dhomave të veçanta për të miturit apo gratë etj. dhe nxit për më shumë rezultate pozitive në përmbushje të respektimit të personave të privuar nga liria në ambientet policore. Për këtë arsye, bazuar në gjetjet e monitorimeve të planifikuara dhe në kuadër të këtij raundi vëzhgimesh si dhe bazuar mbi verifikime e ankesave të shtetasve drejtuar KShH-së, kemi përpunuar disa sugjerime që i parashtrojmë më poshtë.

KShH tërheq vëmendjen e autoriteteve të policisë së shtetit që të marrin masa të mëtijshme për të parandaluar ushtrimin e dhunës fizike dhe psikologjike ndaj personave të mitur, ose të rritur, e cila përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të personave të privuar nga liria. Në rastet kur këto situata fatkeqësisht ndodhin, viktimës i duhen krijuar të gjitha kushtet për ta denoncuar atë dhe vetë strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit duhet të reagojnë menjëherë, për mjekimin dhe rikuperimin e viktimës, si dhe vënien përpara përgjegjësisë së fajtorëve. Organet drejtuese të policisë duhet të vlerësojnë më shumë, e më mirë edhe njoftimet, që subjektet monitoruese ju bëjnë, në lidhje me ankesat e marra, ose konstatimet për ushtrim dhune ndaj personave të shoqëruar, ndaluar ose arrestuar.

KShH sugjeron përdorimin gjithmonë të dhomave të rezervuara për mbajtjen e të miturve, kur këta të fundit gjenden në ambientet policore në cilësinë e të shoqëruarit apo të ndaluarit dhe të evitohet mbajtja e tyre në të njëjtën dhomë me të rriturit. Gjithashtu, duhet të ndalohet përdorimi i të miturve si rrugë për marrjen e informacioneve, lidhur me çështjet në hetim, ku janë të përfshirë persona të tjerë që ndodhen në një dhomë me të miturin. KShH tërheq vëmendjen e strukturave policore se këto janë shkelje të rënda të të drejtave të të miturve në ambientet policore.

Meqenëse u konstatuan mungesa të njohurive të personelit të policisë për identifikimin e veçorive apo simptomave që paraqesin personat e sëmurë mendorë në ambientet policore, KShH i sugjeron strukturave të policisë të rrisin ndërgjegjësimin dhe profesionalizmin e punonjësve të policisë në këtë drejtim. Po ashtu duhet të shmangen paragjykimet e punonjësve të policisë për këtë grup.

Bërja prezent e të drejtave të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar, që në momentin e parë të përballjes me policinë e shtetit, është një e drejtë themelore, e cila duhet të respektohet në çdo rast. KShH sugjeron që këtij aspekti t'i kushtohet më shumë vëmendje nga strukturat policore me qëllim që të unifikohen standardet në gjitha institucionet e policisë, mbi bazën e shembujve pozitivë të cituar në raport. Për më tepër, KSHH sugjeron përsheptimin e procesit të filluar gjatë vitit 2012 për

përmirësimet ligjore të ligjit “Për policinë e shtetit”, sidomos në lidhje me disa dispozita që ndikojnë drejtpërsëdrejti në respektimin më të mirë dhe trajtimin e duhur të personave të shoqëruar, ndaluar, apo arrestuar.

KShH sugjeron zbatimin e afateve procedurale të mbajtjes së personave në ambientet policore, në të gjitha komisariatet e policisë së vendit, ashtu siç janë të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Marrja në pyetje e personave të ndaluar dhe arrestuar duhet të kryhet gjithmonë në prani të avokatit të personit dhe në rastin e personave të mitur, të respektohet edhe detyrim ligjor për prezencën e psikologut, familjarit apo kujdestarit.

KShH sugjeron marrjen e masave edhe në drejtim të përmirësimit të shërbimit shëndetësor në institucionet policore. Siç u konstatua nga vëzhgimet ky shërbim linte shumë për të dëshiruar sa i takon cilësisë së tij, po ashtu edhe furnizimit me ilaçe. Ri sjellim në vëmendje këtu rastin e shtetasit të gjetur në komisariat nr. 5 në Tiranë, gjendja e të cilit përbënte trajtim jo human dhe degradues.

Duke vlerësuar përpjekjet e strukturave të policisë për të përmirësuar infrastrukturën e ambienteve ku mbahen të shoqëruarit/ ndaluarit/ arrestuarit, KShH sugjeron përshpejtimin e procesit, si dhe tërheq vëmendjen për mirëmbajtjen e atyre mjediseve që tashmë janë përmirësuar. Mobilimi i mjediseve me pajisjet e nevojshme si karrige, krevate, shtroje të pastra, ofrimi i mjeteve për mbajtjen e higjienës së mjedisit dhe asaj personale etj. janë një domosdoshmëri për arritjen e standardeve të duhura në trajtimin njerëzor të këtyre personave.

KShH përshëndet nismat e ndërmarra nga policia e shtetit për vënien në përdorim të deklaratës së të drejtave apo edhe të regjistrit të kërkesë-ankesave, dokumente këto që i shërbejnë plotësimi të standardeve të kërkuara nga ligji dhe aktet ndërkombëtare. Nga ana tjetër nxit strukturat drejtuese të këtyre institucioneve t’i plotësojnë, jo vetëm formalisht këto dokumente, por dhe të veprojnë, në mënyrë të përshtatshme, për të

orientuar organet vartëse, që të përmbushin qëllimin e tyre, si dhe t'i mbikëqyrin ato në mënyrë të vazhdueshme.

KShH, për të disatën herë e ngre çështjen e vonesave për transferimin e personave në institucionet penale. Mbajtja e personave në mjediset e policisë, jashtë afateve ligjore, përbën shkelje, prandaj KShH sugjeron për të intensifikuar bashkëpunimin, për të shmangur këtë shkelje ligjore të të drejtave të personave të privuar nga liria.

Po ashtu, nisur nga problematika e konstatuar, pothuajse të gjitha komisaritet e policisë, lidhur me mbajtjen në komisariate të personave të arrestuar, të dënuar me vendim të formës së prerë, persona në kërkim, pas daljes së urdhrit të ekzekutimit të vendimit penal nga prokurori dhe në tejkalim të afateve të përcaktuara ligjore, KShH sugjeron marrjen e masave nga DPB, DPPSH dhe Prokuroria e Përgjithshme për shmangien e të tilla vonesave të pajustificuara dhe ndërmarrjen e studimeve të përbashkëta për të gjetur rrugët e mjetet më të përshtatshme për parandalimin e situatave të tilla.

KShH sugjeron rritjen e vëmendjes për sa i takon plotësimit të nevojave materiale që kanë strukturat policore për përmbushjen e detyrave të tyre funksionale, krahas rritjes së vazhdueshme të profesionalizmit për sa i takon qasjes së konceptit të policimit në komunitet, nëpërmjet të cilit zhvillohet koncepti mbi policinë si strukturë e cila prodhon siguri për të gjithë qytetarët, duke përfshirë edhe ata persona që janë në konflikt me ligjin.

Së fundi do tu sugjerojmë nënshkrimin, sa më parë, të marrëveshjes së bashkëpunimit midis DPPSH dhe KShH, në kushtet kur midis palëve është arritur mirëkuptimi lidhur me përmbytjen e kësaj marrëveshjeje.

Shtojca

**Letra dërguar autoriteteve shtetërore
dhe disa nga përgjigjet e marra prej tyre**



Nga: Zaj. Vjollca Meçaj
Drejtoe Ekzekutive

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSbH)
e respektimit e të drejtave të personave
ambientet e komisariateve të policisë,
në ambientet e Komisariateve të
Gjirëkastër.

Megjithatë, dëshirojmë të sjellim në v
në këto institucione. Më konkretisht,
godinë e Drejtorisë së Policisë V
dhomat e ndalim/arrestimit ishin në
përparatshëm dhe të përpunueshëm
vetëdijshëm për situatën, na u bë me
dhomave, me mbështetjen financiare
hap pozitiv në këto drejtë, i cili do t
sugjerojmë që të gjenden mundësit
prilet që ato të rikonstruktoben. Më
ndërhim dhe ajrosje të mjaftueshme
përshtatshme, përben në vetvete një m

Lidhur me vëzhgimin në Komisariorikonstruktura, qoftë për personelin arrestuar përbejnë një hap pozitiv në Megjithatë, për t'u nënvijëzuar ish rikonstruktura, të cilat nuk përmbes

Address: Fr. Gjin Dae Shquti,
PR. 5/1, Ap. 4, Tirana-Albania
P. O. Box: Karta Postare No. 1752



Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) në kundërshtim me të drejtat e të paraburgosurve ndërmarrë monitorim në ambientet e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Së pari dëshirojmë të falënderojmë strukturat e aksesit e mundësuar gjatë kryerjes së vëzhgimit dhe gjatë intervistave me personat e paraburgosur.

Të dy institucionet e vëzhguara janë të ndërtuara në infrastrukturë, të cilat hasen në institucionet e kundërta respektivisht të të drejtave të njeriut të përgjithshme dhe të vazhdojnë ndërgjegjësimi i punonjësve në institucione.

Megjithatë, dëshirojmë të sjellim në vëmendjen për përmirësimin e situatës në këto institucione,

1. Nga vëzhgimi rezultoi se, sa i takon probleme lidhur me zbatimin e strukture dhe funksionimit të sistemit të informacionit në nivel lokal.

08.10.2012
Prakt. 438



Lenda: Informacion lidhur me Inspektimin e kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Drejtuar: Znj. Vjollca Mecaj
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

© 2005 Blackwell Publishing Ltd *Journal of Internal Medicine* 258: 103–111



Address: 4000 Tupper (Grand Teton) WY
Tel: 406.362.2077 ext 207 Fax: 406.362.2077 ext 207 info@www.adultworld.com www.adultworld.com

Tiranë, më 20/6/2012

Līdzdarb. Mācībspēji ir monitorējami arī LE.V.P.Vīdēs

Drejtuar: Znj. Vjollca Mecaçi
Drejtore, Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Rr. Gjin Buzë Shqata
PIL 5/1, Ap 4, Tirana, Albania

Drejtoria e Përgjithshme e Bursave punë u njoh me raportin e monitorimit kryer në IEVP Vlorë nënshkrimet shkruara tani me nr 360 Post. datë: 01.08.2012, ju bëjmë me dije si vijon:

- [illegible]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

2248/ Adresa: Rruga «Qemal Stafa» Nr.1, Tiranë. Tel./faks: ++35542225990
Nr. Prt. (A-D) Tiranë, më

Tiranë, më 05.09.2012

Lēnda : Pērgiigic shkresēs tuai Nr.368 datē 31.07.2012.

KOMITETIT SHQIPTAR TE HELSINKIT

Zn]. VJOLLCA MEÇAJ

TIRANE

gjithshme, i'u sqarojmë se:
hë shumicën dërmuese të rasteve, nxjerrja
zbatimin e vendimeve penale të formës së
il i tyre në organin e Prokurorisë nga ana e
kështat e nenit 48 të ligjit Nr.8331 datë
nin e vendimeve penale".
lejuar zvarritje në nxjerrjen në kohë të
rë edhe masa konkrete ndaj personave
të të vendimeve penale të Prokurorisë së
noce, ndërsa për prokurorin e ekzekutimit
Gjyqësor Kordë është filluar procedimi
legjitarit një qarkore ku u është tërhoqur
in korrekt të ligjit, lidhur me ekzekutimin

RGJTHSHĚM

12 lidhur me inspektimin e bere
n tone, ju veme ne dijeni se nga
na nga ana juaj duke analizuar
ektimit ju informojme se:

jar kushte sa me te mira jetese tr
rsa i perket trajtimit te denuarve
e se per cdo te denuar diabetike
artikujve dhe normave ushqimore
u shperndahehet ketyre te denuarve
denuarit diabetike ne momentin e

de denuarve diabetike, sto
ucionin tone per cdo vakt.

dijeni se çdo i denuar furnizohet gjëje.
 Është ben te mundur largen dhe
 , kollefeve te jastikut etj. per te
 one, per ti krijuar kushte sa me



5

10

--

[illegible]